



BULETIN

MARS 2015

Adela DANAJ
Blerina LALLA
Brenton KOTORRI
Elena PICI
Flutura GJANA
Gerion TRESKA
Jona HOXHAI
Megi LLUBANI
Rezarta CAUSHAJ
Sokol KONDI

Ky publikim u mbështet nga Friedrich Ebert Foundation, zyra e Tiranës.

*Faktet, analizat dhe qëndrimet e publikuara nga APPA, nuk shprehin opinionin e partnerëve tanë.

KRYEMINISTRIA

Brenton KOTORRI, BA

1-Në shërbim të kryeministrit.

Kryeministria e Shqipërisë, si institucion, është e tëra nën drejtimin e Kryeministrit, mirëpo në shërbim të gjithë pjesës tjetër të administratës, si dhe në shërbim të qytetarit. Kjo nuk ndodh në rastin tonë. Në fakt, në rastin e Shqipërisë, kryeministria është institucion i cili njësohet në formë dhe përmbajtje me Edi Ramën, kryeministrin. Këtë traditë joprofesionale të tranzicionit shqiptar, duket se kryeministri po e trashëgon për të mos shkuar më pranë standardeve të BE-së *për një administratë në shërbim të qytetarit*, por për një administratë në shërbim të drejtuesit. Le ta nisim këtë raport me shpresën se shumë shpejt kjo kulturë do të ndryshojë dhe se punonjësit e administratës sonë do të kreditohen për meritat dhe arritjet që realizojnë, dhe nuk do të fshihen gjithnjë pas hijes së Kryeministrit.

Që në fillim të muajit, kryeministri Rama udhëtoi drejt Vlorës duke i dorëzuar çelësat e një banese të re Znj. Dhora Gjoni, banesën e mëparshme të së cilës e dëmtuan përmytjet e muajit shkurt në Novoselë. Në të njëjtën ditë për ironi, kryeministri viziton edhe punëtorët e projektit të Rrugës Transballkanike që është duke nxjerrë si të pastreha 150 familje. Moskorrektësia politike vazhdon teksa kryeministri deklaron: *"Pasi u zgjidh problemi me të gjitha familjet që duhet të lironin banesat e tyre për çeljen e kësaj rruge, sot jam shumë i kënaqur që fillon më në fund, pas shumë e shumë vitesh, të realizohet projekti ..."*. Dhe më pas shton: *"... Bashkë me pjesën tjetër të vijës bregdetare apo Lungomaren siç i thonë vlonjatët, janë dy projektet e mëdha që do të çelin fuqishëm rrugën e rilindjes së plotë*

të infrastrukturës të këtij qyteti ...", a thua se qytetarët e shpërngulur prej shtëpive do të lumturoheshin, qetësoheshin dhe ngushëlloheshin prej këtyre fjalëve. Gjatë kësaj dite Z. Rama shpërndau gjithashtu edhe dëshmitë e legalizimeve të radhës, pa harruar sigurisht batutat e veta si kryeministër, por ama personale ndaj qytetarëve, të cilët nuk guxojnë kurrsesi t'ia kthejnë si qytetarë sepse përtej personit, ai është kryeministri. Një tjetër dilemë e lëvizjeve politike në qeveri, është nëse ministrja e Zhvillimit Urban, që shoqëron kryeministrin zakonisht në show-t e tij, e lëshoi për pamundësi menaxhimi sektorin e turizmit, apo sepse turizmi dhe zhvillimi urban në Shqipëri përbëjnë paradoks po të vendosen pranë.

Edhe pse i zhytur në dallgën oqeanike të ngritur prej rrëfimit, ku deputeti i PS Tom Doshi pretendonte se kishte zbuluar një atentat për vrasje ndaj tij, kryeministri gjeti kohën që të përruronte Qendrën Rinore të Tiranës. Do t'i kthehemi QRT, sapo të servirim vetëm dy hipoteza rreth çështjes Doshi. Së pari, pse kryeministri Rama menjëherë pas akuzave të Tom Doshit në vend që të solidarizohej me të si një koleg partie (minimalisht) doli në deklaratë duke i pretenduar akuzat e Doshit si "histori të shëmtuar"? A kishte informacion paraprak kryeministri i vendit, që e bëri të merrte një vendim jo vetëm politik, por mbi të gjitha juridik mbi rrëfimin e Doshit? Nëse po, pse nuk e kishte informuar paraprakisht publikun? Së dyti, pse kryeministri përshëndeti kërkesën e Prokurorisë për arrestimin e Doshit, ndërkohë që Prokuroria në vetvete na sjell një dimension më thellë në këtë dilemë: Pse prokuroria, duke pasur dy pista hetimi mbi tryezë (1- Ilir Meta ka paguar për të vrarë Tom Doshin; 2- Tom Doshi gënjen), zgjedh të ndjekë pistën e dytë. Kjo do të thotë parimisht, se Prokuroria në vetvete ka arritur përmes hetimit të shuajë çdo dyshim që pista e parë është e pavërtetë.

Faktet që pista e parë është e pavërtetë, nuk u publikuan asnjëherë.

Le të mjaftohemi me pyetjet për momentin, duke qenë se e gjithë kjo çështje do të kërkonte një hetim të jashtëzakonshëm, sikur vetëm në aspektin politik e asgjë tjetër. Le të kthehemi tek QRT. Papritur, ashtu sikurse ka ndodhur deri më tani me Zyrat e Punës në të gjithë Shqipërinë, apo me Zyrat e Kujdesit Social, edhe me Zyrat e Rinisë asnjëherë nuk u bë publike thirrja për të rekrutuar punonjës për to. Edhe në këtë rast, kryeministri nuk e humbi mundësinë për të ironizuar mungesën e kryetarit të bashkisë së Tiranës në këtë event, a thua se ai vete shkonte në eventet e përrurimeve qeveritare kur ishte dikur kryebashkiak (kujtojmë për analogji mungesën e Z. Rama në përrurimin e Qendrës TEN).

2- Moratoriumi i gjuetisë, shteti laik, dhe mjedisi.

Në këtë muaj të rrëmujshtëm një prej sukseseve që qeveria festoi, ishte mbyllja e moratoriumit 1 vjeçar të gjuetisë në parkun e Divjakës. Sigurisht që sukseset e vogla kërkojnë zotime edhe më të mëdha. Le të urojmë që kjo qeveri dhe të tjerat që do të vijjnë do të veprojnë me përgjegjshmëri të shtuar ndaj mjedisit.

Më datë 11 mars, kryeministri mori pjese në një ceremoni për 90 vjetorin e Medresesë së Tiranës, ku vetëm duke parë fjalimin e tij me këtë rast, mund të kuptohet se si instrumentalizohet sërish besimi fetar si dekor politik. Kjo pasi kryeministri e konsideron institucionin fetar si garant të laicitetit shtetëror. Një silogjizëm i përmbysur i cili të bën të mendosh se religjioni ka për qëllim garantimin e shtetit laik, kur në fakt, thelbi i çdo lloj religjioni është të afrojë sa më shumë njerëz të Perëndia. Mirëpo kryeministri nuk e konsideron asnjëherë këtë, por përkundrazi, gjen rastin t'i kujtojë institucionit fetar në parim, një

pakt të heshtur. Paktin se nëse institucioni fetar (cilidoqoftë) nuk cenon laicitetin, atëherë shteti do t'i dhurojë lirinë për të ekzistuar.

Një tjetër sukses të cilin Rama e inspektoi personalisht, ishte nisja e punimeve për Impiantin e Trajtimit të Mbetjeve Urbane në Elbasan. Le të urojmë gjithashtu që ky impiant të realizohet në kohë dhe kushtet më të mira, dhe të hapë rrugën për impiante përpunimi në të gjithë Shqipërinë.

Më 18 mars kryeministri mbajti një fjalim të gjatë për të promovuar iniciativën e hapjes së dosjeve të informacionit sekret, të periudhës së regjimit komunist. Gjatë këtij fjalimi, kryeministri mori sigurisht të gjitha meritat për këtë iniciativë, dhe u përpoq ta fshihte faktin që kjo është një direktivë e drejtpërdrejtë prej BE-së përtej dëshirës ose mosdëshirës, vullnetit apo pavullnetit të cilësdo palë.

Më tej gjatë muajit kryeministri përdori një klishe tashmë të konsumuar në lidhje me informatizimin e mëtejshëm të administratës. Në një moment të fjalës së tij, ai thotë: *"Për këtë arsye, ne jemi të angazhuar shumë fort në këtë drejtim dhe një plan tërësor, që përfshin prekjen përmes teknologjisë së re të mbi 300 shërbimeve që ofrohen sot për qytetarët shqiptarë është tanimë në veprim. Ambicia jonë është që në vitin 2017, pjesa dërrmuese e këtyre shërbimeve të mund të ofrohen online për qytetarët"*. E gjitha kjo të bën të mendosh se nga ana tjetër mirëqenia e shqiptarëve është e tillë sa ata të mund të kenë një pajisje si PC, apo Smartphone që t'u mundësojë atyre aksesin nga çdo fshat sado i largët, në këto shërbime.

3- Patriotizmi i pashembullt

Më 23 mars, u zhvillua ajo që u quajt edhe ngjarja e muajit në politikën e jashtme, takimi i dy qeverive Shqipëri-Kosovë. Përtej gjithë ndjenjave dhe emotivitetit që

ky takim përcolli, le të shohim më nga afër dy aspekte: 1- Protokollet e nënshkuara; 2- Takimi në këndvështrimin rajonal. Për aspektin e parë, lista e protokolleve të nënshkuara shkoi në 11, mirëpo asnjë prej këtyre protokolleve nuk premtonte ndonjë përmirësim reformues të marrëdhënieve, apo ndonjë përfitim të menjëhershëm politik-ekonomik. Po t'i vërejmë me kujdes këto 11 nënshkrime, do të shohim se në fakt janë dokumente që Shqipëria do të duhej t'i nënshkruante me të gjitha vendet fqinje, dhe mbi të gjitha, edhe sikur të refuzonte t'i nënshkruante, direktiva për bashkëpunim në rajon është e drejtpërdrejtë prej BE-së, dhe në këtë rast, të dyja vendet janë të etura për t'iu bindur këtyre direktivave. Aspekti i dytë, na bën të shkojmë drejt pyetjes, a ia vlen të shijojmë një shfaqje populiste për të rrezikuar marrëdhëniet me fqinjët? Sigurisht që këto marrëveshje mund të ishin nënshkruar pa nevojën e një mbledhjeje të dekoruar për efekte psikologjike.

Vetëm një ditë më pas, në tryezën e Dialogut të Nivelit të Lartë Shqipëri-BE, kryeministri deklaroi ndër të tjera se "... jemi besimplotë se në vjeshtë, ne do t'i japim Komisionit në dorë gjithçka të plotësuar, lidhur me të 5 prioritetet... ". Këto 5 prioritete (1-Krijimi i një administrate profesionale dhe të depolitizuar; 2-Forcimi i pavarësisë të institucioneve të drejtësisë; 3-Lufta kundër korrupsionit; 4-Lufta kundër krimit të organizuar; 5-Mbrojtja e të drejtave të njeriut), janë kaq evazive, sa që në çdo rast nuk do të mund të konsideroheshin dot të ezauruara, apo të plotësuara, pasi secili prioritet në vetvete nënkupton një proces të vazhdueshëm dhe jo një vendmbreritje statike. Kështu, vetëm vjeshta do të na dëshmojë nëse qeveria do të ketë realizuar plotësisht deri në tetor: Reformën në administratë, reformën në drejtësi, reformën anit-korrupsion, dhe reformën e gjerë në rend publik dhe liritë

kushtetuese. Vjeshta do të na tregojë gjithsesi nëse qeveria do t'ia dalë, apo ky premtim nuk do të mbahet dot jo vetëm ndaj qytetarëve, por as ndaj BE-së.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTEVE

Gerion TRESKA, MSc

Muaji mars si dhe disa prej ditëve të fundit muajit shkurt, kanë mirëpritur diskutimet mbi Draft Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar të lançuar nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit. Pas hartimit nga ekspertët e arsimit, dokumenti është diskutuar me partnerë të ndryshëm. Aktivitetet e diskutimit të draftit, me qëllim gjithëpërfshirjen si dhe pasurimin e cilësisë së saj janë organizuar me mbështetjen e UNDP.

Gjatë prezantimit të këtij dokumenti, titullarët e Ministrisë kanë theksuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së arsimit në Shqipëri si një domosdoshmëri dhe prioritet në arsimin parauniversitar. Ndërtimi i skemës së re të prioritetëve u mirëprit nga të gjithë aktorët pjesëmarrës duke nënvizuar mbështetjen konkrete të deritanishme të secilit prej donatorëve dhe palëve të tjera.

Ajo çka u vu re së pari është se shuma e akorduar për arsimin parauniversitar nuk ka rritje domethënëse. Ajo u rrit saktësisht me 2.19%, krahasuar me 2.53% të PBB dhe është shumë larg premtimit të Programit të Rilindjes, i cili thotë se burimet financiare nuk do të jenë më pak se 5% e PBB. Sipas Ministrisë, ky dokument është propozim për transformimin, për reformimin dhe për zhvillimin e arsimit, sipas një modeli të frytshëm planifikimi, menaxhimi dhe vlerësimi.

Puna për hartimin e Strategjisë ka filluar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në prillin e vitit 2014. Gjatë periudhës prill-gusht 2014, u përgatit "Raporti Paraprak për Reformën e SAPU-së". Nga diskutimi i gjetjeve dhe i propozimeve të Raportit u përftua korniza e konceptimit të

Strategjisë, objektivat dhe pritshmëritë sipas përparësive të përcaktuara.

Në vitin 2014, u organizuan tre workshop-e, në të cilët ekspertë vendas dhe të huaj, mësues, përfaqësues të organizatave të ndryshme dhe shoqëria civile kanë kontribuar në identifikimin e pikave të forta, problemeve, vështirësive dhe në zhvillimin e kornizës konceptuese.

Megjithëse synimi i kësaj strategjie duket mjaft ambicioz, vihet re nevoja e domosdoshmërisë së prezencës së donatorëve ndërkombëtarë si dhe organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të tjera për të mbushur boshllëqet e strategjisë.

Përfaqësues të APPA Tank kanë marrë pjesë në takimet e diskutimit të Draft Strategjisë duke ofruar sugjerimet dhe pikëpyetjet e tyre. Mbetet për t'u shqyrtuar dhe analizuar se si do të reflektohen të gjitha sugjerimet e grumbulluara në Strategjinë përfundimtare e cila do të shkojë për miratim në qeveri.

MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJRAVE

Adela DANAJ, BA

1-Alarm për produktet ushqimore shqiptare. Rusia indiferente do të heqë embargon.

Ka disa kohë që qytetarët shqiptarë ndjehen të pasigurt në lidhje me cilësinë e ushqimeve që konsumojnë. Për këtë arsye më datë 17 Mars, Ministria e Bujqësisë ka ndërmarrë një iniciativë shumë të rëndësishme në lidhje me kontrollet periodike që do të organizojë ndaj fermerëve. Sipas ministrisë, ata fermerë që do të konstatohen se kanë abuzuar me të mbjellat e tyre dhe prodhojnë produkte me kimikate dhe hormone tej normave të lejuara do të ndëshkohen.

Paradoksisht, Ministri i Bujqësisë Edmond Panariti pohon se prodhimet shqiptare janë më bio se ato të importuara. Ai kërkoi të shmangen spekulimet në media se prodhimet tona bujqësore janë të ndotura me kimikate, madje pohon se në bazë të analizave të bëra, rezulton se prodhimet tona janë më të pastra, më bio, se ato të importuara, në drejtim të pranisë se insekticideve apo pesticideve të përdorura për rritjen e tyre.

Ministri, ka theksuar se në media po spekulohet në lidhje me këtë çështje, dhe për të vërtetuar vlerën e tyre ai sollti si argument faktin që prodhimet tona kërkohen dhe eksportohen në Danimarkë, Zvicër, Holandë, Gjermani, etj.

Ndoshta, ministria ka të drejtë, media mund të jetë duke spekuluar, por qytetarët që konsumojnë këto lloj ushqimesh vazhdojnë të jenë të shqetësuar dhe kanë nevojë të "çlirohen" nga dyshimet. E

vetmja formë, ndoshta do të ishte ndëshkimi i rasteve që konstatohen abuzive gjatë këtyre kontrolleve periodike, të cilave të shpresojmë se do t'i nënshtrohen të gjithë në të njëjtën mënyrë. Ndoshta ministri ka pasur disa arsye kur ka pohuar se mediat ndoshta janë duke spekuluar, pasi po më 17 Mars, bëhet i ditur lajmi se Rusia do të heqë embargon ndaj produkteve bujqësore shqiptare.

Më 16 Mars, Ambasadori ynë në Moskë, Arben Gazioni, ka zhvilluar një takim në Ministrinë e Bujqësisë së Federatës Ruse, Agjencinë e Kontrollit Veterinar dhe Fitosanitar, me qëllim zhblokimin e embargos ruse për eksportet e produkteve bujqësore shqiptare në tregun rus dhe duket se ky takim ka qenë i suksesshëm. Kujtojmë se embargo e u vendos në fund të vitit të kaluar, kur Agjencia Federale Ruse për Mbikëqyrjen Veterinare dhe Fitosanitare vendosi të ndalojë importin e frutave dhe perimeve nga Shqipëria, nga data 8 dhjetor 2014, me argumentin se, mallrat shqiptare shoqëroheshin me një çertifikatë fitosanitare false. Ky lajm është i mirë jo vetëm në lidhje me sigurinë e cilësisë së prodhimeve bujqësore shqiptare, por dhe për arsyen se Rusia ishte shndërruar në një nga destinacionet kryesore të frutave dhe perimeve që Shqipëria shet jashtë.

A është kjo një garanci se të gjitha prodhimet bujqësore shqiptare do të përmbushin të gjitha standardet e kërkuara apo këto kushte do të duhet të plotësohen në mënyrë specifike vetëm për ato ushqime që e kanë destinacionin për diku jashtë Shqipërisë?

Duhet të kujtojmë se kontrolli ndaj këtyre produkteve është dhe një nga prioritetet e Qeverisë për sektorin e Bujqësisë dhe Blegtorisë dhe sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave janë arritur këto vendime:

Vendim i KM. nr. 260, datë 27.3.2013 "Për caktimin e rregullave për kontrollin, marrjen e mostrave, analizave e të procedurave, dhënien e rezultateve të tyre, si dhe vlerësimin e analizave të plehrave"

Vendim i KM nr. 87, datë 30.1.2013 "Për përcaktimin e kritereve të tregtimit, certifikimit dhe testimit të farave foragjere"

Kjo do të thotë se proceset e kontrollit dhe sanksionet kundrejt abuzuesve janë domosdoshmëri në një situatë të tillë, ku dyshimi është më i madh se vetë popullsia.

2- Marrëveshje Bashkëpunimi me OBBU.

Firmoset Marrëveshja Kuadër e Bashkëpunimit midis qeverisë shqiptare, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Organizatës Botërore të Bujqësisë dhe Zhvillimit (FAO) për periudhën 2015-2017. Kjo marrëveshje u firmos nga Ministri i Bujqësisë Z. Edmond Panariti dhe përfaqësuesi rajonal i FAO-s për Evropën, Z. Tony Allonzi, më datë 19 Mars.

Marrëveshja përmban katër prioritet kryesore të bashkëpunimit, të cilat janë: 1- Ruajtja dhe administrimi i burimeve natyrore, 2- ndryshimet klimaterike dhe administrimi i fatkeqësive natyrore, 3- zhvillimi i kapaciteteve për hartimin e politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural në Shqipëri, duke e vënë theksin në mbështetjen e rolit të gruas në këtë drejtim, 4- Përafrimi i politikave bujqësore dhe zhvillimit rural me standardet evropiane. Kjo marrëveshje do t'i përgjigjet kërkesave emergjente në drejtim të politikave dhe prioriteteve të qeverisë shqiptare në sektorin e bujqësisë.

Ky duket se është një lajm i mirë në një kohë kur qeveria Shqiptare e ka thuar se të pamundur: 1-të menaxhojë rastet e fatkeqësive natyrore, (rasti i fundit, ndodhur një muaj më parë); 2-të përafrojë politikat bujqësore me standardet evropiane.

Referime

<http://www.mapo.al/2014/03/produktet-pesticide-dhe-hormone-ministria-kontroll-farmacive-dhe-fermave>

<http://acp.al/news/735/Rusia-do-te-heq-embargon-ndaj-produkteve-bujqesore-shqiptare>

<http://www.balkanëeb.com/site/ministri-panariti-marreveshje-me-fao-n-per-zyren-e-re-ne-shqiperi/>

<http://www.bujqesia.gov.al/al/programi/zhvillimi-rural/bujqesia-dhe-zhvillimi-rural>

<http://www.bujqesia.gov.al/al/lajme/njofti-me-per-shtyp/ministria-e-bujqesise-firmos-marreveshjen-e-bashkepunimit-kuader-me-organizaten-boterore-te-bujqesise-dhe-ushqimit>

MINISTRIA E DREJTËSISË

Elena PICI, BSc

1- Reforma në drejtësi, kyç për demokracinë

Ishte kjo kryefjala e takimeve, që si një refren që përsëritet, u theksua edhe nga Komisioneri për Politikën e Fqinjësisë Evropiane dhe Negociatat e Zgjerimit, Johannes Hahn, i cili vizitoi zyrtarisht për herë të parë Shqipërinë në fund të muajit Mars. Të gjithë krerët më të lartë të shtetit miratuan dhe përforcuan nevojën për të realizuar këtë reformë, e cila duhet të ecë me vendosmëri krahas për krahas me luftën e pakompromis ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. Të gjitha fjalë kyçe. Fjalë, dhe me besim veprime konkrete, për të cilat shqiptarët shpresojnë; opozita kërkon me ngulm; Bashkimi Evropian kërkon për të çelur negociatat e aderimit; dhe qeveria premton të realizojë në këtë mandat si pjesë e platformës së saj për shtetin e së drejtës dhe demokratizimin e shoqërisë. Në fakt, kreu i qeverisë Z. Rama, në një konferencë për shtyp me Z. Hahn, deklaroi guximshëm se pesë pikat prioritare të caktuara nga BE do të realizohen brenda muajit Shtator 2015, rrjedhimisht edhe reforma në drejtësi.

Megjithatë, e analizuar kritikisht, ky afat kohor është tejet sfidues, në një kohë që Ministria e Drejtësisë ka ende shumë punë për të koordinuar që kjo reformë të draftohet cilësisht, të miratohet dhe më pas të implementohet nga institucionet e përfshira. Vetë Z. Hahn u shpreh se: *“Ne si BE jemi të vendosur për të mbështetur Shqipërinë që të ecë përpara sa më shpejt të jetë e mundur, por çështja nuk është shpejtësia por cilësia”*.

Nëse do të analizojmë çfarë Ministria e Drejtësisë ka realizuar në këtë një vit e gjysmë në lidhje me këtë prioritet të saj, vëmë re se jemi vetëm në kuadrin

analizues. Në muajin Janar 2015, Ministria publikoi analizën e sistemit të drejtësisë, tek e cila do të bazohet edhe reforma. Për sa parashtrohet në këtë dokument, reforma në sistemin e drejtësisë duhet të orientohet në këto shtylla kryesore, por jo vetëm:

- Ndryshimi i Kushtetutës, reformimi i Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese;
- Reformimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Reformimi i Prokurorisë dhe i Policisë Gjyqësore;
- Reformimi i Shkollës së Magjistraturës dhe Arsimit Juridik;
- Reformimi i Organizimit Gjyqësor;
- Reformimi i Avokatisë;
- Reformimi i profesioneve të lira në sistemin e drejtësisë;
- Luftën kundër korrupsionit në sistemin e drejtësisë;

Në mbështetje të reformës, në muajin Shkurt, Ministri Naço, prezantoi dhe grupin e këshilltarëve me katërmbëdhjetë juristë të njohur të vendit. Ndërkohe ai ka qenë i pranishëm në takimet ku është analizuar puna e disa gjykatave apeli në vend, ku dhe ka ndarë sugjerimet e tij. Në tërësi, me gjithë ekzistencën e grupit këshillues dhe vullnetit të mirë politik që u shpalo dhe me vizitën e Z. Hahn në Tiranë, analiza e punës së Ministrisë së Drejtësisë deri në muajin Mars tregon se ka ende shumë punë dhe plot ligje për t'u miratuar në funksion të reformës, të cilat të bëjnë të mendosh se premtimi i realizimit në Shtator është larg të mundurës cilësisht.

2- Në gjurmim të të drejtave të pronësisë

Në programin e Ministrisë së Drejtësisë parashikohet strategjia ndërsektoriale e reformës në fushën e të drejtave të pronësisë 2012-2020. Pjesë e implementimit të reformës është edhe krijimi i regjistrimit elektronik të pasurive të

paluajtshme duke shfrytëzuar maksimalisht jo vetëm kapacitetet vendase dhe burimet buxhetore, por edhe asistencën e projekteve ndërkombëtare në proces. Procesi i dixhitalizimit të informacionit të ZRPP-së (Zyra për Regjistrimin e Pronave të Paluajtshme) do të jetë gradual, fillimisht me zonat kadastrale të Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit, për të vijuar me të gjitha zonat e tjera. Në këtë kontekst, shtyllë bazë do të jetë dixhitalizimi i informacionit që krijon dhe shpërndan ZRPP-ja, jo vetëm si tipar modernizues i shërbimit, por edhe si premisë për shërbime transparente.

Për të monitoruar pikërisht punën e ZRVPP (Zyrave Vendore për Regjistrimin e Pronave të Paluajtshme), Ministri Naço gjatë muajit Mars ka qenë në Durrës, Kavajë dhe Vlorë. Megjithatë, fjala e tij nuk u fokusua kaq shumë tek procesi i dixhitalizimit, sesa tek kapacitet njerëzor, të cilat sipas Ministrit Naço nuk mund të zëvendësohen nga asnjë teknologji e re dhe moderne. Jemi të mendimit se puna e Ministrisë së Drejtësisë duhet të sigurojë edhe stafin e kualifikuar dhe teknologjinë e përshtatshme dhe lehtësuese, sipas parashikimeve të reformës.

Referime

Ministria e Drejtësisë. Mars 2015. *Newsroom-Lajme*
<http://www.drejtesia.gov.al/al/neesroom/lajme>

Ministria e Drejtësisë. Janar 2015. *Analiza e sistemit të drejtësisë.*

<http://www.drejtesia.gov.al/al/prioritete/analiza-e-sistemit-te-drejtësisë>

Ministria e Drejtësisë. 2012. *Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë.*

http://www.drejtesia.gov.al/files/userfiles/Strategjite_ndersektoriale/Strategjia_Refor

[ma_ne_fushe_e-te-drejtave_te_pronësisë.pdf](#)

Mapo.al. 24 Mars 2015. *Reforma në drejtësi, kyç për demokracinë*

<http://www.mapo.al/2015/03/reforma-ne-drejtësi-kyc-per-demokracinë>

Shqiptarja.com. 24 Mars 2015. Hahn: *Ju duam në BE...kujdes drejtësinë!*

<http://shqiptarja.com/m/home/hahn-ju-duam-n--be---kujdes-drejt-sin---ramagatin--shtator-280758.html>

MINISTRIA E INDUSTRIË DHE ENERGJITIKËS

Gerion TRESKA, MSc

Projekti TAP mbetet në qendër të vëmendjes së bashku me sektorin energjetik jo vetëm për takimet e njëpasnjëshme dhe thirrjet për investitorë por edhe sepse në të njëjtën kohë sipas Kryeministrit Rama, energjitika ka qenë një nga sektorët burim për rritje ekonomike. Marrëveshjet e njëpasnjëshme të Ministrit Gjignuri dhe të ardhurat nga TAP apo projekte të tjera, përfshirë këtu edhe privatizimin e Albpetrol, nuk duket se bindin ekspertët e FMN, të cilët parashikojnë një rritje ekonomike më pak se 3%.

Jehona e gazifikimit të Shqipërisë përmes Projektit TAP ka vënë si asnjëherë më parë në lëvizje institucionet përkatëse shtetërore, në veçanti në çështjet e pronësisë së tokës që preket nga projekti. Një shenjë e qartë kjo se kur qeverisë i interesojnë të ardhurat, di mjaft mirë se si të zgjidhë një nga problemet më madhore të investitorëve të huaj, çështjet e pronësisë.

Qeveria Zvicerane ka dhënë një grant prej 6.6 milion Eurosh për zhvillimin e infrastrukturës së gazit në Shqipëri. Ministrat Gjignuri dhe Cani u shprehën mjaft entuziastë për bashkëpunime të mëtejshme në fushën e efijencës së energjisë me Qeverinë Zvicerane. Një fond tjetër ky i cili mbështet procesin e gazifikimit të Shqipërisë. Ndërkohë që shifra grantesh dhe marrëveshjesh publikohen thjesht si shifra, nuk duket në horizont asnjë plan pune me hapa dhe afate të cilat do të matin dhe rezultatet e implementimit dhe realizimit të objektivave për të cilët janë dhënë këto grante.

Një procedurë e re privatizimi po përgatitet sipas Kryeministrit për privatizimin e

Albpetrol. Thënë shkurt, qeveria nuk ka kapacitetet financiare apo çfarëdo lloj kapaciteti tjetër të nevojshëm për ta reformuar dhe kthyer në efijencë të plotë këtë kompani. Megjithatë Kryeministri theksoi se procesi do të jetë transparent dhe gara e hapur dhe konkurruese. Një tjetër aset privatizimi i të cilit pa dyshim do të ja vështirësojë jetën qytetarëve, por do të rrisë të ardhurat e shtetit. Le të shpresojmë që këto të ardhura do të përdoren ashtu siç janë premtuar për përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve dhe jo të politikanëve.

Ndërkohë që planet për të ardhmen duken mjaft të qarta, administratori i OSHEE deklaroi se borxhet e biznesit janë ende të mëdha dhe se ka një rënie të humbjeve të energjisë, megjithatë kjo mbetet në nivele të larta në kryeqytet më 37% të konsumit. Në mesin e muajit Mars, OSHEE deklaroi «dëm ekonomik» dhe «energji e pa matur» për 51 000 fatura me vlerë 4.1 miliardë Lekë për periudhën 2008-2011. Duket se bizneset, sidomos ato të ndërtimit, nuk kanë borxhe vetëm ndaj OSHEE por shpesh për mbijetesën e tyre iu drejtohen tregjeve kredimarrëse informale. Përafërsisht janë 35% e bizneseve të cilat përdorin kredimarrjen në rrugë informale.

MINISTRIA E FINANCAVE

Elena PICI, BSc

1- Në ngërçin e të ardhurave buxhetore

Në një kohë që strategjia 2013-2017 e qeverisë parashikon rritje të të ardhurave buxhetore (të cilat ishin në rënie të vazhdueshme në periudhën 2010-2013), dhe paralelisht qeveria rrit disa taksa të rëndësishme, të ardhurat buxhetore ngecin në vetëm 0,3% rritje (reporter.al), krahasuar me periudhën e një viti më parë. Dhe po krejt ndryshe nga premtimet në programin e këtij mandati, shpenzimet e qeverisë pësojnë rritje në masën 6%. Në këtë situatë që logjikshëm bie ndesh me parashikimet financiare të zhvillimit ekonomik, mund të aludojmë se qeveria mund të jetë në pritje të ndonjë granti surprizues dhe dobiprurës, ose ndryshime drastike në menaxhimin e financave do të ndodhin në gjysmën e dytë të vitit.

Megjithatë, Ministri Cani në çdo dalje shprehet optimist për situatën dhe për efektet pozitive që do të japin reformat në të ardhmen. Me qetësi të habitshme, ai pretendon se të gjitha këto rezultate kanë qenë brenda parashikimeve, prandaj dhe plani 2015 është më i ulët se ai 2014. Ministri lavdëron punën e bërë nga doganat dhe tatimet, dhe arkëtimet e tyre të ulëta këtë fillimviti në rastin e parë ai ia adreson problemeve me rentën minerare, çmimin botëror të naftës dhe fushatës anti-duhan, kurse në rastin e dytë thekson të jetë një situatë kalimtare, pasojë e sistemit të ri online tatimor.

2- Doganat në fokus

Rënia e të ardhurave, dorëheqja e Elisa Spiropalit dhe performanca e agjencisë angleze këshillimore Crown Agents, kanë qenë arsye të mjaftueshme që t'i bënin doganat kryefjalë të financave këtë muaj.

Në një të shtunë ku Shqipëria festonte ditën e mësuesve, në këtë 7 Mars, televizionet u pushtuan nga lajmi i dorëheqjes së Drejtoreshës së Doganave dhe komandimit në këtë pozicion të Zv. Ministres së Financave, Irena Beqiraj. Për aq kohë sa nuk u emërua një drejtor i ri/drejtoreshë e re, duket se dorëheqja ka qenë e papritur. Megjithatë argumenti që dha Spiropali, ardhja në jetë e fëmijës së saj të parë, ishte fakt që dihej prej muajsh, ndonëse zëra qarkullonin për një shkarkim të saj për mosarritje të performancës së pritur. Nga ana tjetër, emërimi i Znj. Beqiraj, e cila aktualisht mban të dyja pozicionet, e bën gjithashtu të vështirë për të, që të performojë maksimalisht në të dy detyrat, prandaj dhe koha e vendosjes së një kreu të ri s'duhet të jetë e largët.

Nga ana tjetër as performanca e Crown Agent nuk ka shkëlqyer. Në një kohë që pritshmëritë e arkëtimeve nga doganat për 2014 ishin 4% e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), reporter.al sjell në vëmendje se kjo shifër ka qenë vetëm 0,4% e PBB-së, duke treguar që edhe strategjia e qeverisë për rritje të disa taksave, edhe puna asistuese e Crown Agent kanë dështuar. Megjithatë, ajo çfarë të bën më shumë përshtypje, është kërkesa e Crown Agent, një kompanie që përfiton 4.1 milionë EUR. në vit, që të rinovojë kontratën pavarësisht se nuk ka përmbushur të gjitha kushtet e saj. Do të ishte vërtetë e habitshme sikur qeveria të pranonte të rinovonte këtë kontratë, në një kohë që në një letër drejtuar Fondit Monetar Ndërkombëtar, vetë Rama ka pranuar që puna e Crown Agent nuk ka qenë sipas pritshmërive dhe nga na tjetër ai vetë në 2013 premtoi se doganat nuk do kalonin në menaxhim të huaj. Besojmë se një eksperience jo e mirë, mjafton!

3- Edhe më shumë hua...

Në programin e qeverisë 2013-2017, tekstualisht përmendet: Rritja ekonomike

për një vend si Shqipëria mund të vazhdojë të nxitet në tre mënyra:

a) *Nëpërmjet borxheve dhe kredive nga jashtë;*

b) *Nëpërmjet eksporteve të lëndëve të para, të disa produkteve të gatshme dhe një kategorie të caktuar shërbimesh;*

c) *Nëpërmjet ristrukturimit ekonomik dhe reformave të vërteta strukturore, rritjes me prioritet të prodhimit të brendshëm, diversifikimit të produkteve dhe shërbimeve, adoptimit masiv të teknologjive të reja.*

Dy mënyrat e para ne i gjykojmë se janë me nivel të lartë risku dhe jo të qëndrueshme. Ta mbështetësh rritjen vetëm tek investimet apo kreditë e huaja, gjë që na ka pëlqyer ta përmendim si "kulmin e suksesit të çdo qeverie" do të thotë: të ushqesh iluzionin e një jetese dhe zhvillimi përtej mundësive të tua konkrete, të jesh i varur shumë nga flukset, "devijimet" dhe "kapriçot" e shpeshta të tregjeve financiare ndërkombëtare, të prodhosh një rritje ekonomike jo reale, të mbështetur në monedha të fuqishme e të mbivlerësuar, të cilat sintetizojnë një strukturë.

E pavarësisht kësaj, qeveria ka vijuar të marr borxhe nga jashtë. Kryesisht nga FMN-ja, e cila është praktikisht tashmë mbikëqyrësi dhe drejtuesi i ekonomisë sonë, por edhe nga burime të tjera siç është Banka Botërore. Voice of Albanias raporton se qeveria do të marrë një borxh prej 250 milionë eurosh, i cili, siç shpjegoi ministri Cani është "një hua që ka interesa relativisht më të ulëta, sepse garantohet nga Banka Botërore".

Në një konferencë për shtyp me Shefin e Misionit të FMN-së në vendin tonë, Nadem Llahi, ku ky i fundit u shpreh optimist për rritjen ekonomike 3% të Shqipërisë në vitin 2015, Ministri Cani tha se nuk do të kishte rritje të mëtejshme taksash. Të

njëjtën gjë përmendi dhe Drejtoresha Aktuale e Doganave, Znj. Beqiraj, në çastin që u komandua në këtë post, por Albanian Construction Portal, raporton se në Shtator qeveria do të zbatojë taksën e re mbi pronën. Nuk dihet ende qëllimi, destinacioni dhe vlera e kësaj takse, por një deduksion i thjeshtë të bën të mendosh se me vendosjen e taksës imobilare, do bien çmimet e ndërtesave për shkak të uljes së kërkesës si pasojë e rritjes së çmimit nga taksa. Me shumë mundësi zinxhirët e kleringut do të thyhen dhe do këtë falimentime të furnitorëve të ndërtimit dhe rrjedhimisht punëtorët e ndërtimit do të humbin punën, duke sjellë më pas kosto ekonomike dhe sociale, të cilat nuk dihet nëse taksa do t'i mbulojë dot. Qeveria nën trysninë për t'u përgjigjur me proteksionizëm për çmimet imobiliare në rënie, do të bllokojë ndërtimet e reja. Përndryshe, le të imagjinojmë qindra shqiptare, që kanë blerë apartamente që kujtojnë se u vlen 100 mijë EUR dhe të nesërmen vlera u bie në 30 mijë EURO ...

4-Në luftë me informalitetin

Për një Shqipëri që në 2016 të zgjohet pa shqetësime nga lojërat e fatit. Ky është qëllimi i projektligjit "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", që u prezantua në Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese me datë 18 Mars 2015. Ministri Cani deklaroi se për këtë sektor do të ketë një skemë të ri tatimi: "Lojërat e fatit përjashtohen nga TVSH, por tarifa për t'u licencuar do të variojë nga 40 mijë lekë në 1 miliardë lekë për kazinotë e mëdha". Ndërkohë projektligji parashikon edhe distanca më të largëta mes kazinove, vendosjen jashtë qyteteve (kryesisht në pika turistike) dhe aplikimin e regjistrimit të lojtarëve.

Vlen për t'u përsëritur fakti që familja do të ketë në dorë që përmes një kërkesë të bërë të mos lejojë që i afërmi i tyre të mund të lejohet të luajë në lojërat e fatit. Mbetet të urojmë që ky ligj do të aplikohet

më së miri, sipas gjithë parashikimeve për të luftuar informalitetin, evazionin fiskal dhe luftën kundër efekteve sociale.

Referime

Reporter.al. 23 Mars 2015. Qeverisë i ngecin të ardhurat buxhetore, në shkurt vetëm 0.3 për qind më shumë <http://www.reporter.al/qeverise-i-ngecin-te-ardhurat-buxhetore-ne-shkurt-vetem-0-3-per-qind-me-shume/>

InfoPasqyra. 18 Mars 2015. *Cani: Reformat, efekte pozitive në ekonominë shqiptare.* <http://infopasqyra.com/cani-reformat-efekte-pozitive-ne-ekonomine-shqiptare/news/lajmi/>

Reporter.al. 23 Mars 2015. *Crown Agents, konsulenca e kushtueshme që nuk solli të ardhura shtesë.*

<http://www.reporter.al/croen-agents-konsulenca-e-kushtueshme-qe-nuk-solli-te-ardhura-shtese/>

Albanian Contruction Portal. 26 Mars 2015. *Ne shtator qeveria aplikon taksen e re mbi pronën.*

<http://acp.al/nees/730/Ne-shtator-qeveria-do-te-zbatoje-taksen-e-re-mbi-pronen/>

Agjencia Telegrafike Shqiptare. 18 Mars 2015. *Ligji për lojërat e fatit-Cani: Objektiv, lufta kundër informalitetit.*

<http://www.ata.gov.al/ligji-per-lojrat-e-fatit-ministri-cani-objektiv-luften-kunder-informalitetit-238485.html>

Shqiptarja.com. 18 Mars 2015. *Ligji për kazinotë.* <http://shqiptarja.com/m/home/ligji-p-r-kazinot--cani-familja-k-rkes--q--i-af-rmi-t-mos-lejohet-279551.html>

Gazeta online Panorama. 8 Mars 2015. *Dorëheqja e Spiropalit.* <http://www.panorama.com.al/doreheqja-e-spiropalit-cani-uroj-nenen-elise-e-ka->

shprehur-qarte-arsyen-bashkepunim-i-shkelqyer/

Ministria e Financave. Qershor 2013. *Programi i Qeverise 2013 -2017.* <http://www.financa.gov.al/al/program/programi-i-qeverise-2013-2017>

Voice of Albanians-Online. 17 Mars 2015. *Emetimi i eurobondit dhe marrja e huase.* <http://www.voal-online.ch/index.php?mod=article&cat=LAJMIF&article=52851>

Gazeta Tema. 17 Mars 2015. *Shqipëria vijon rritjen ekonomike.* <http://www.gazetatema.net/ëeb/2015/03/17/fmn-shqiperia-vijon-rritjen-ekonomike-permiresime-ne-sektorin-energjitik-cani-ska-rritje-taksash-jemi-ne-rrugen-e-duhur/>

MINISTRIA E INTEGRIMIT EUROPIAN

Rezarta CAUSHAJ, BA

1. Shqipëria dhe integrimi rajonal

Nëse i referohemi punës së Ministrisë së Integritimit gjatë muajit Mars, ajo ka konsistuar në takime intensive në kuadër të vizitave nga zyrtarë të ndryshëm evropianë në vendin tone, apo edhe eventeve të tjera të ndjekura nga Ministri, Znj. Gjosha. Për t'u përmendur ishte Konferenca e Komisioneve Parlamentare të Ballkanit Perëndimorⁱ e datës 13 Mars, e kryesuar nga vendi ynë me qëllimin për të ndarë përvojën e integritimit dhe si një inkurajim i bashkëpunimit më të thelluar midis vendeve të rajonit. Ajo çka mbetet mister mbas një kërkimi për sa i përket raportimit mbi konferencën në fjalë, është a ka patur përfaqësues të vendeve të rajonit në këtë takim? Një fakt i tillë është i pamundur të deduktohet, si nga mbulimi mediatik që ka patur, po ashtu edhe nga ai i faqes zyrtare të Ministrisë, të cilat kanë publikuar vetëm fjalimet e zyrtarëve pjesëmarrës të vendit tonëⁱⁱ. Si rrjedhim, nuk arrijmë të kuptojmë qëndrimin e vendeve fqinje ndaj një nisme të tillë, vizionin e tyre apo projektet konkrete, për të cilat flitet ndër vite me radhë në të tilla konferenca, por që nuk arrijnë të prodhojnë politika të përbashkëta. A ishte kjo konferencë e kryesuar nga Shqipëria e suksesshme apo ishte një konferencë e vendeve të rajonit, organizuar nga Shqipëria, ku Shqipëria ftoi vetveten dhe pastaj foli për veten?

E vërteta është që Ballkani ka nevojë për më tepër konferenca të përbashkëta, që të organizohen pikërisht me iniciativë rajonale dhe të kalojnë në një tjetër nivel, duke zbuluar fushat më të përshtatshme për bashkëpunim e duke prodhuar politika specifike që jetësojnë këtë bashkëpunim. E gjithë kjo për të theksuar se destinacioni

përfundimtar i Shqipërisë mund të jetë Bashkimi European, por i vetmi "tren" që e çon atë atje është integrimi rajonal dhe ka ardhur e ka kaluar koha, që iniciativat e përbashkëta të trajtohen me seriozitet e jo për të bërë deklaratat e zakonshme për fqinjësinë.

Ndër të tjera, muaji Mars ka qenë akoma edhe më i ngjeshur në takime dhe zhvillimi intensiv i tyre është një aspekt për t'u përgëzuar. Si vend kandidat, Shqipëria duhet të kalojë në një proces negociatash, të cilat për dëgjuesin e thjeshtë, shpeshherë, duken si deklaratat pa kuptim në takime që përsëriten pa fund. Për vendimmarrësit politikë këto deklaratat kanë rëndësi të veçantë sepse tregojnë ecurinë (ose jo) të integritimit dhe nëse publiku është i vëmendshëm ka arritur të kuptojë se gjuha e BE është bërë më "e mprehtë" e më "kërkuese", në një kohë që nga një konstatim i Newsletter-it Eurospeakⁱⁱⁱ të Lëvizjes Europiane në Shqipëri nga raporti i Marsit i Parlamentit European mbi vendet e Ballkanit Perëndimor, sugjeron se progresi kushtëzohet nga kriza ekonomike, korrupsioni dhe nevoja për të garantuar lirinë e medias.

Vazhdimisht në deklaratat në media gjen referenca mbi faktin se Znj. Gjosha në takime ka raportuar mbi reformat, ndërkohë që asnjë raport institucional nuk është bërë i njohur për publikun. Nuk është e rëndomtë atëherë që Eurodeputetja Macovei, si kryetare e delegacionit të Parlamentit European deklaroi se " Fjalët, dokumentet, strategjitë nuk janë të mjaftueshme. Ato janë të nevojshme, por duhen zbatuar."

2. *Acquis Communautaire – Quo Vadis?!*

Komisioneri i Bashkimit European për Politikën e Fqinjësisë Europiane dhe Negociatat e Zgjerimit, z. Johannes Hahn^{iv} në vizitën e tij të 20 Marsit përveçse bëri të qartë, si të tjerë kolegë të tij më parë,

se Shqipëria në fakt nuk ka asnjë faktor të jashtëm pengues për anëtarësimin dhe i vetmi preokupim ka të bëjë me implementimin e reformave dhe gjithashtu një çështje të ngritur si shqetësim edhe nga APPA në raportin e muajit Shkurt, mbi rëndësinë e përafrimit të legjislacionit. Z. Hahn u shpreh: “Gjithashtu është me shumë rëndësi që të ecet përpara me implementimin e legjislacionit, pasi procesi i integritit për çdo vend që aspiron të bëhet pjesë e Bashkimit Europian nuk ka të bëjë vetëm me përshtatjen e legjislacionit të një vendi me atë të BE-së, por me zbatimin e tij në praktikë”. Një çështje e ngritur me të drejtë duke qenë se as Ministria e Integritit, as Drejtoria e Ligjeve të Bashkimit Europian, as Komisioni i Integritit, që kanë detyrën kryesore për monitorimin e procesit të *Acquis* së bashku, nuk ka publikuar asnjë raport mbi mënyrën se si procesi i përafrimit ka shkuar deri tani, jo vetëm në terma sasiorë në kuptimin e sa ligjeve janë arritur të përshtaten, por edhe në cilësi apo edhe në pasqyrimin e problematikave që hasen. Deri tani, informacioni i vetëm që Ministria e Integritit i ofron publikut janë disa paragrafë në faqen zyrtare që japin në vija të përgjithshme se në çfarë konsiston *Acquis*^v (Ndëqni likun në fund të raportit).

Pyetjet lindin natyrshëm: a ka Ministria e Integritit një plan të caktuar për zbatimin e *Acquis Communautaire* për një periudhë kohe të caktuar dhe si po shkon ky plan? Në c’ mënyrë sigurohet që mbas përshtatjes së Legjislacionit, të sigurohet njëkohësisht edhe zbatimi i dispozitave të reja?

Duhet të përmenden këtë muaj edhe 3 mbledhjet e zhvilluara në Komisionin e Integritit, ku megjithëse duhet të themi se niveli i përgjithshëm i debatit duket se ka një përmirësim nga muaji i kaluar, sërish mbetet në pikëpyetje cilësia dhe zbatueshmëria e ligjeve të prodhuara.

Kalimi i ligjeve në komisione ndjek një procedurë të caktuar, vihet re se shumica e punës bëhet jashtë dyerve të këtyre takimeve. Si rrjedhim, është e vështirë të kuptohet se si është cilësia e ligjit të prodhuar krahasuar me atë paraardhës, a ka patur vështirësi në përshtatjen me ligjet e BE, a ka ligje apo edhe thjeshtë dispozita të veçanta të cilat janë të pa aplikueshme në vendin tonë dhe si i bëhet në të tilla raste? Për më tepër, gjithnjë duke u bazuar në proces verbalët, është e qartë se diskutimi i ligjeve vazhdon të jetë më tepër objekt negociatash midis partive në pozitë dhe atyre në opozitë, ku ajo çka prodhohet nuk është ligji më i mirë i mundshëm, fruti i një pune profesionale, por i përplasjeve partiake. Mund të konkludojmë se të vetmit aktorë që nuk përmenden janë qytetarët vetë, të cilët marrin pjesë në mënyrë të tërthortë në momentin që u jepet akses i plotë në të gjithë procesin e ligjvënies dhe debati ekspozohet tërësisht ndaj kritikave të tij.

3. *Trekëndëshi Macovei – pozitë – opozitë*

Ngjarja më e rëndësishme, që nga marrja e statusit kandidat, ka qenë takimi midis përfaqësuesve të Parlamentit Shqiptar me ata të Parlamentit Europian^{vi} zhvilluar në datat 16-17 Mars, që shënuan përplasje midis opozitës dhe europarlamentares Macovei duke u mbyllur pa rekomandime nga ana e kësaj të fundit. Për suksesin e takimeve për hapjen e negociatave do të veçojmë dy versione, atë të Znj. Gjoshë dhe atë të Znj. Macovei. Në një intervistë dhënë në datën 25 Mars për **“Revistën Televizive të Mbrëmjes”^{vii} në Top Channel**, në kuadër të vizitës së komisionerit Hahn dhe delegacionit të Parlamentit Europian, **Znj. Gjoshë është shprehur shumë e kënaqur me prezantimin si një “front i bashkuar” mes qeverisë dhe opozitës përballë BE dhe citojmë:** “Mund të them që ishte tejet i suksesshëm edhe për diçka shumë

të veçantë që nuk ka ndodhur më parë, dialogu mes mazhorancës dhe opozitës ishte me të vërtetë i admirueshëm.”

Ndërkohë europarlamentarja Macovei^{viii} në një intervistë të dhënë për ABC News shprehet se ka përshtypjen se qytetarëve shqiptarë iu ka ardhur në majë të hundës me skandalet në Parlament apo në instanca të tjera, si dhe se, sistemi partiak dominohet nga një person. Këtë e dëshmon fakti, sipas saj, se shumë nga deputetët e opozitës ishin dakord me amendamentet e draft-rezolutës, por që më vonë do t’i shpreheshin asaj se nuk mundeshin t’i pranonin se atë urdhër kishin.

Pra, dialogu midis mazhorancës dhe opozitës në këtë rast nuk ishte “i admirueshëm” dhe duhet të bëhet një sforcë më e madhe për të koreografuar qëndrimet e tyre përpara se takime të tilla të ndodhin. Nëse do guxojmë të kemi shpresë për suksesin e negociatave të ardhshme, një nga problemet që duhet të zgjidhet është që duhet të paraqitemi si një front i bashkuar, duke përfaqësuar popullin shqiptar, jo interesat elektorale.

4. Ministri apo Ministria???

Titullari i Ministrisë së Integritimit, Znj. Gjoshë, mori pjesë në prezantimin nga Fondacioni SOROS i përfundimeve të anketimit të zhvilluar në nivel kombëtar “Perspektiva e Anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, perceptime dhe realitete”^{ix}, nga ku ajo veçoi se mbështetja e përgjithshme në favor të anëtarësimit shkon diku te 87 %. Ajo çka Znj. Gjoshë ka adresuar nga anketimi në fjalë ka qënë sidomos pjesa e perceptimit të shqiptarëve se me hyrjen në BE, ky i fundit do t’i lajë, pastrojë, pasurojë e kulturojë, duke u shprehur që i tillë perceptim duhet të ndryshojë në funksion të ndërgjegjësimit për të përmbushur detyrimet.

Në një kohë që retorika politike

përqendrohet gjerësisht në përfitimet që integrimi do t’i sjell vendit tonë, është e pakuptueshme përse ende publiku shqiptar nuk njihet në mënyrë periodike me punën konkrete që zhvillojnë departamentet e kësaj Ministrie, përtej një përshkrimi të përgjithshëm në Organigramën e Ministrisë. A nuk do ishte e kuptueshme dhe e pritshme që Ministria e Integritimit Europian të bëhej një model për ministrinë e tjera, duke bërë transparente punën e saj, por edhe raportimin si një *modus operandi*?!

Referime

<http://www.integrimi.gov.al/al/newsroom/fjalime/fjala-e-ministres-gjoshë-gjate-konferences-se-kryetareve-te-komisioneve-parlamentare-per-politiken-e-jashtme-te-vendeve-te-ballkanit-perendimor>

<http://telegraf.al/politike/meta-cdo-nisme-ti-sherbeje-ekonomise-ka-ikur-koha-e-politikave-te-vjetra>

<http://eurospeak.al/zgjerimi/291-infografika-vleresimi-i-progresit-te-ballkanit-perendimor-drejt-integritimit-europian>

<http://www.integrimi.gov.al/al/programi/parafrimi-i-legjislacionit>

<http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=295037#k1>

<http://www.top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=295534#relin>

http://www.gazetastart.com/makovei-si-i-nxorem-nga-politika-te-inkriminuarit_40459.html

<https://www.osfa.al/publikime/anketimi-kombetar-mbi-perceptimet-pritshmerite-drejt-anetaresimit-te-mundshem-te-shqiperise-ne-be>

MINISTRIA E KULTURES

Blerina LLALLA, MSc

1- Ri-restaurimi i Muzeut Arkeologjik të Durrësit.

Nga veprimtaria e ushtruar gjatë muajit mars të Ministrisë së Kulturës vihet re një angazhim pothuaj kostant për sa i përket realizimit të aktiviteteve sipas profilit të institucionit, në bashkëpunim me institucionet e saj të vartësisë, në rend kronologjik të vazhdueshëm sipas kalendarit artistik e kulturor. Gjithashtu një ekspozim apo njoftim më i gjerë nëpërmjet medimeve të komunikimit publik rreth eventeve apo artistëve pjesëmarrës, kohës apo përmbajtjes së tyre.

Por nëse do të fokusoheshim tek ato aktivitete që konsiderohen prioritare për nga funksioni i këtij dikasteri, gjatë këtij muaji më i promovuari ishte hapja për publikun e Muzeut Arkeologjik të Durrësit pas rreth 5-vitesh ndërprerje. Ky aktivitet pati vëmendje nga disa nivele qeveritare të cilët ishin prezentë në ceremoninë e çeljes.

Nga burime të informimit publik ky inaugurim vjen pas deklaratave të fundvitit të kaluar të cilat lajmëronin çeljen e këtij muzeu në sezonin pranveror. Jemi në kohë atëherë. Mbi shkallën e realizimit të rehabilitimit do të mësojmë më poshtë.

Gjatë ceremonisë së hapjes, disa deklarata nga vetë kreu i këtij institucioni dhe përfaqësues të tjerë i atribuohen qeverisë së shkuar. Është shqetësues fakti që ende pas dy vitesh në qeveri përfaqësuesit zyrtarë promovojnë arritjet apo finalizimin e çdo projekti duke cilësuar vetëm aspekte negative (sipas disa këndvështrimeve të ndryshme) të paraardhësve të tyre. Kryefjala përshëndetëse në çdo rast mbetet qeveria e shkuar. Por ndoshta kjo është një mënyrë efikase për të orientuar vëmendjen publike drejt së shkuarës dhe

palës tjetër, për të shmangur vëmendjen mbi transparencën e disa proceseve specifike dhe kostove të investimeve nga buxheti i shtetit. Një teknikë komunikimi e aplikuar nga çdo klasë politike që nuk të orienton të hedhësh vështrimin drejt së ardhmes por të mban të atakuar veç në të shkuarën për të hedhur hi mbi të tashmen.

Nëse do ti referohemi informacioneve ndër vite mbi çështjen në fjalë dimë se ky Muze i një rëndësie të veçantë për nga përmbajtja dhe në kontekstin historik e kulturor, u mbajt i mbyllur për rreth 5 vite për shkaqe jo shumë të qarta, por më i lakuari mbetet ai për një konflikt mbi pronësinë e truallit ku gjendet i vendosur ky Muze. Argumente të tjera përveç komenteve për abuzime me fondet nuk ka. Ajo që dimë është se dëmi i shkaktuar nga ky fakt është sa infrastrukturor aq dhe ekonomik.

Muzeu arkeologjik i Durrësit u ndërtua në vitin 1951 me iniciativën e studiuesit dhe arkeologut Vangjel Toçi dhe u ka shërbyer shumë vizitorëve.

Ndërsa godina e re e Muzeut të sotëm u ndërtua dhe u përrua në prill të vitit 2002 me financim të një donatori gjerman, duke i ardhur më pranë publikut me një hapësirë më të madhe ekspozimi. Por disa vite më vonë u mor vendimi për një rehabilitim të këtij Muzeu për shkak të mosmirëmbajtjes nga specialistët e fushës dhe për shkak të gjendjes së rënduar në të cilën ndodheshin objektet historike.

Në vitin 2010 u dhanë nga buxheti i shtetit një milionë e dyqind mijë dollarë për të realizuar të gjithë procesin e realizimit të restaurimit. Punimet filluan në vitin 2011 dhe projekti parashikonte ndërhyrje në fasadën e godinës tre katëshe, izolim tarrace, rehabilitim sheshi para godinës, si dhe vënien në funksion të katit të dytë që nuk ka qenë i hapur për vizitorët. Procesi pritej të mbyllej në një hark kohor prej tetë muajsh por u ndërpre për shkak të

pretendimeve mbi pronësinë e truallit nga një qytetar, si dhe për shkaqe teknike. Mbyllja e punimeve u bë e mundur në fund të 2013-s. Pas kësaj faze rikonstruktimi, filloi puna për muzealizimin e tij dhe rikspozimin e objekteve historike, proces që mori më shumë se një vit kohë.

Përtej mosrespektimit të afateve të caktuara nga të gjithë funksionarët e këtij dikasteri që kanë kaluar në duar këtë proces, ende sot e kësaj dite nuk ka pasur argumente konkrete mbi arsyet dhe shkaqet e këtij pezullimi. Mungesa e raporteve vjetore dhe analizave të punës për publikun e bën akoma më të pamundur evidentimin e problematikave të këtij procesi në vazhdimësi për 5-vite me radhë. Kjo në mënyrë që të justifikohen mungesat dhe harxhimet prej 1,2 milionë dollarësh, të cilat natyrisht janë menaxhuar në çdo fazë të projektit në vazhdimësi, dhe jo në një dorë të vetme, si një këst i vetëm.

Duke mos pasur asnjë deklaratë apo raportim para publikut nga ministrja Kumbaro, e cila pati rastin të asistojë dhe fazën përfundimtare të këtij projekti mbi investimet e deritanishme sipas fazave përkatëse, është akoma më e vështirë për ne të kuptojmë se si janë menaxhuar këto fonde dhe të arrijmë të bëjmë evidencë mbi kostot që kanë shkaktuar vonesat, pasojat e të cilave mund t'i dimë.

Por ministrja Kumbaro mjaftohet me një deklaratë gjatë ceremonisë zyrtare duke cilësuar se; për këtë restaurim nuk kishte plan, as projekt dhe as fond për muzealizimin e tij dhe sidomos oborri i muzeut nuk ishte pjesë e projektit.

Një deklaratë disi kontradiktore në vetvete sepse thuhet se nuk ka plan, nuk ka projekt dhe kur vjen çështja e oborrit, thuhet se nuk ishte pjesë e projektit.

Atëherë referuar kësaj deklaratë ne pyesim se si qenkan lëvruar gjithë këto fonde nga buxheti i shtetit, dhe si janë realizuar

tenderët përkatës kur nuk ka pasur një plan dhe projekt konkret?

Dhe nëse ky fond është lëvruar e me të nuk është bërë asgjë (sipas deklaratës së Ministres në dhjetor 2014), çfarë është bërë me këto 1.2 milionë dollarë që po na shndërrohen në një fjalë goje?

A ka hetuar Ministrja mbi këto shpenzime dhe dëme?

Cilat janë masat e ndërmarra për të kompensuar këtë dëm dhe për të qetësuar opinionin publik ndaj këtij fenomeni nga ana e Ministres?

A ka bërë Ministrja deklarata përpara qeverisë, publikut dhe institucioneve të drejtësisë në lidhje me këtë rast?

Për të justifikuar dëmet dhe për të marrë masat e duhura ndaj shpërdoruesve të detyrave, si dhe për të ruajtur një imazh të mirë personal apo institucional aktual nuk mjaftojnë fjalët e thëna në erë që mund ta bëjnë më konfuz publikun ndaj fakteve reale dhe asaj çka u thuhet.

Komunikimi në publik është përgjegjësi dhe impakti i tij bie drejtpërdrejt mbi imazhin, besueshmërinë dhe performancën e vetë institucionit. Prandaj deklarata të tilla nuk janë korrekte dhe të qëndrueshme deri në momentin që nuk shoqërohen me argumente dhe detaje konkrete e profesionale.

Tashmë jemi mësuar të jemi pjesë vetëm e momenteve përruese apo inauguruese dhe ceremonira finale vetëm në fillimet dhe përmbylljet e çdo procesi, sepse për publikun nuk sigurohet një informim konstant mbi vazhdimësinë e çdo projekti apo nisme me interes publik. Kjo ndodh vetëm në rastet kur bëhet fjalë për vonesa dhe justifikime të rastit nga ana e palëve përgjegjëse.

Atëherë për të pasur një informim sa më të saktë të publikut do të ishte më mirë të ndaheshin përgjegjësitë dhe të jemi

realistë duke thënë se të dyja palët e përfshira në këto procese kanë përgjegjësi mbi mbarëvajtjen e punimeve dhe procedimeve përkatëse, përfshi këtu edhe stafet apo specialistët e paguar nga shteti për të punuar dhe ushtruar funksioni e tyre në shërbim të çdo programi dhe plani pune.

Projekt ka patur, pasi, pa u përmbyllur faza restauruese nuk mund të kalohet tek projekti për muzealizimin apo restaurimin, pastrimin e konservimin e objekteve historike. Sikurse dhe investimet kanë qenë të shifrave të konsiderueshme pasi procesi i restaurimit dhe konservimit apo pastrimit të objekteve historike kërkon kohë dhe ka kosto të larta, por ajo që nuk dimë janë shifrat reale të këtij investimi.

Po ashtu kuptojmë se në të dyja rastet e menaxhimit të këtyre punimeve kemi të bëjmë me ndërhyrje në fasade, mure, kolona dhe në mënyrat e ekspozimit të objekteve në ambientet e brendshme pasi sipas informacioneve të tjera dihet se ndryshe nga sa është thënë nga të dyja palët ende nuk janë rehabilituar kati i dytë dhe i tretë të këtij muzeu dhe ky do vazhdojë të jetë në fokus të punës së institucioneve të kulturës në vijim. Që do të thotë ato punime që janë zhvilluar janë të së njëjtës kategori dhe projekt ide, mund të ndryshojnë ngjyrat dhe servirja e informacionit.

Tani për tani le të themi që më në fund u bë i mundur përpara çeljes së sezonit turistik një Muze me vlera të veçanta historike dhe i një rëndësie të madhe për kulturën dhe turizmin kulturor Shqiptar.

MINISTRIA E MBROJTJES

Megi LLUBANI, MSc

1- Edhe njëherë për trajtimin me ushqim

Shumë u përfol muajin e kaluar mbi rikthimin e trajtimit me ushqim për ushtarakët, pas Vendimit të Këshillit të Ministrave në vitin 2013, për ta hequr kompensimin e ushqimit duke shfuqizuar ligjin e mëparshëm. Më konkretisht, sipas VKM nr. 184^x "Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, kur nuk trajtohen me ushqim të gatuar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, si dhe kur duhet të trajtohen me ushqim, por nuk kanë infrastrukturën për gatim dhe servirje ushqimi, përfitojnë kompensim në vlerë leku, si më poshtë vijon: a) Oficerët aktivë të Forcave të Armatosura 2 000 (dy mijë) lekë në muaj; b) nënoficerët aktivë të Forcave të Armatosura 3 000 (tre mijë) lekë në muaj; c) ushtarët aktivë të Forcave të Armatosura 4 000 (katër mijë) lekë në muaj;"

Ky vendim shfuqizon VKM-në nr. 668 të vitit 2013 që e hiqte trajtimin me ushqim për forcat ushtarake të Republikës së Shqipërisë. Në fjalimet e saj Ministria e Mbrojtjes është krenuar më këtë vendim si një nga mënyrat për të rikthyer dinjitetin e forcave të armatosura. Ndërkohë që vendimi është për t'u përshëndetur meqenëse rikthen një të drejtë legjitime për këtë kategori, nuk kuptohet nga vendimi se ku janë bazuar hartuesit e tij për vendosjen e kompensimit në shifra pothuajse qesharake (imagjinoni nëse një nënoficer aktiv kryen 4 ditë shërbimi në muaj, kompensimi i tij për çdo shërbim të kryer do të ishte vetëm 500 lekë të vjetra). Së dyti shifra të tilla fikse nuk lejojnë fleksibilitet për përshtatjen e kompensimit me ndryshimet në treg. Ndoshta në hartimin e këtij vendimi mund të ishte marrë parasysh VKM nr. 524 i vitit 2004, që e lë në dorë të Ministrisë së Mbrojtjes në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë,

vendosjen e masës së kompensimit vit pas viti bazuar tek çmimet mesatare vjetore.

2- Bashkëpunim ndërinstitucional

Një projekt pilot i ideuar në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, mundëson të rinj të shkollës Teknike Elektrike Gjergji Canco, të profilizohen më tej në fushën e tyre të zgjedhur duke kryer praktikën shkollorë pranë Forcave të Armatosura. Sikurse deklarohet në një lajmërim për shtyp të Ministrisë së Mbrojtjes: "Zhvillimi i këtyre praktikave nën drejtimin e personelit ushtarak do t'u japë mundësi nxënësve të njihen dhe familjarizohen me mjetet në përdorim të FA, si dhe do t'u jepet mundësia të riparojnë dhe vendosin në funksionim sistemet dhe pajisjet e dëmtuara ushtarake."^{xi} Duket se investime të tilla në kombinimin e kategorive të ndryshme të profesioneve që kanë pikëtakime, do të ndikojë jo vetëm në vënien në praktikë të njohurive të marra dhe dijeve teorike por mund të ndikojë edhe në punën e vetë Ministrisë së Brendshme/Forcave të Armatosura që do të ishin pritëse të studentëve të përzgjedhur.

Referime

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 668, DATË 7.8.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN ME USHQIM TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 524, DATË 30.7.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MASËN DHE MËNYRËN E KOMPENSIMIT TË QIRASË SË BANESËS DHE TË USHQIMIT TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR" Online:
http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/34-2015.pdf Fq. 1565.

Artikulli i plote online:
<http://www.mod.gov.al/index.php/neesroom-2/1027-nje-projektpilot-qe-do-t-i-sherbeje-te-ardhmes-se-fa>

MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

Jona HOXHAI, BSc

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë e zotuar që gjatë mandatit 4 vjeçar të vendosë reforma dhe të bëjë ndryshme të dukshme në vend, vazhdoi dhe gjatë muajt Mars me aktivitete të shumta pa harruar postimet në rrjetet sociale. Qeveria aktuale vazhdimisht vë në dukje gatishmërinë për të qenë transparente dhe e drejtë me publikun, në kuadër të informacioneve publike dhe atyre të "gërmuara në thellësi të transparencës". U evidentua nga të dhënat në raportin e buxhetit të vitit 2015 publikuar nga Ministria e Financave se MMSR ka shumë më të madhe të shpenzimeve mëse 25% të totalit të shpenzimeve të të gjitha Ministrive të tjera. Shtrohet pyetja, "a ja vlen barra qeranë"? Përgjatë Marsit 2015 çështjet kryesore të evidentuara janë:

1- Reforma e pensioneve: Moshë mesatare e daljes në pension drejt mesatares europiane.

Në fillim të vitit 2015 filloi aplikimi i skemës së re të pensioneve, përveç të tjerash një ndër stimulimet kryesore që pritet të arrihet me skemën e re janë deklaratimet reale të të ardhurave nga të gjithë punonjësit që janë aktualisht në marrëdhënie pune, në mënyrë që e ardhmja t'i shpërblehet me pensione më të larta. Ministri Veliq shprehet se me reformën e re dhe rritjen e moshës (65 vjeç për femra e cila do të arrihet në vitin 2032 dhe 67 për meshkuj që do të filloj të rritet me nga 1 muaj nga 2025 dhe do të arrihet në vitin 2052) së pensionit të gjithë pensionistët aktualë dhe ata në perspektive do të përfitojnë pensione më të larta, i mbështetur nga drejtoresha e institutit të sigurimeve shoqërore, (ISSH) Znj. Vjollca Braho, e cila në raportin e publikuar në Mars 2015 cilëson miratimin e

reformës si një ndër arritjet kryesore të këtij institucioni për vitin 2014.

Qeveria aktuale në fund të vitin 2014 shfaqti detajet kryesore të reformës së pensioneve duke theksuar se reforma do të realizohet gradualisht për të shmangur efektet sociale dhe për të rritur pranueshmërinë nga masa. Gjatë muajt Mars Kryeministri Rama dhe Ministri Veliq përuruan edhe zyrat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në kuadër të reformës për pensionet dhe sigurimet shoqërore. Kryeministri në fjalën e mbajtur tha se shërbimet ndaj pensionistëve do të përmirësohen gradualisht duke filluar me daljen nga "strofullat e errëta" ku ata shërbeheshin dikur. Në muajin Mars pensionistët aktualë filluan ta ndjenin ndryshimin në të ardhurat e tyre duke përfituar një shumë më të madhe se sa përfitonin gjatë viteve të kaluara.

Pjesë konstruktive e reformës është dhe heqja e tavanit. Në bazë të përlogaritjeve me formulën e re, heqja e tavanit çon në rritjen e pensioneve për të gjitha kategoritë dhe sektorët e pensionistëve (Reforma e plotë dhe përlogaritja e reformuar e pensioneve e bashkangjitur tek referencat). Vlerë e shtuar e kësaj reforme janë pensionet për grupin e të moshuarve mbi 70 vjeç të cilët nuk përmbushin kriterin e 15 vite përvojë pune, duke përfituar pensione sociale prej 6750 lekë në muaj. Këto pensione janë domosdoshmërisht standard europian për të siguruar mirëqenie për qytetarët e vendit. Efikasiteti dhe efienca e reformës është akoma herët të cilësohet duke qenë se implementimi përfundimtar do të shihet në perspektive. Sfidë e madhe për implementimin e reformës është korniza e kohëzgjatjes së realizimit të reformës. A do të vazhdonte implementimi i reformës nëse qeveria aktuale humb në zgjedhjet e ardhshme? Nga ana tjetër nga buxheti shtetëror i vitit 2015 qeveria ka ndarë 12 milionë USD për rritjen e pensioneve

gjithashtu duke rënë dakord që të mos aplikojnë rritje prej masës së inflacionit.

2- Papunësia në rritje?!

Në mars INSTAT publikoi raportin e fundit të statistikave në të cilin evidentohet rritje në numrin e qytetarëve të Shqipërisë që nuk kanë një vend pune. Në tre mujorin e katërt të muajit 2014 papunësia arriti në 18% nga 17.4% që ishte në tremujorin e tretë. Në kontradiktë me këtë shifër Z.Veliaj në të gjitha deklaratat e tij dhe daljet në publik “mburret” për arritjen dhe realizimin e reformave, duke qenë të informuar se prioritet në programet e MMRS-së ka punësimin e të rinjve. Rritja e papunësisë dhe deklarimi (dhe nga Kryeministri Z. Rama) se numri i të punësuarve total si dhe punësimi legal është rritur gjatë periudhës së qeverisjes së tyre, nuk është etike. Deri në këtë pikë përderisa papunësia është shtuar, përkundër faktit që Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) është rritur, gjithashtu raporti i tranzicionit shpreh rritje të standardeve sociale dhe ekonomike në vend, programi i MMRS-së është drejt dështimit. Vazhdimësia e produktivitetit të programit të punësimit të kësaj ministrie ngelet të shihet në raportet e INSTAT për 2015-n.

3- Hapja e dosjeve, fokusimi në lustracion apo në transparencë?!

Çështja e hapjes së dosjeve dhe lustracionit është në rend të ditës që kur filloi procesi i dekomunistizimit në vitin 1991. Pas zgjedhjeve të vitit 1992, një grup pune pjesë e të cilit ishte dhe Aleksandër Meksi, siguruan të hartonin një projektligj që më pas u vu në jetë me vendimin nr. 407 të K.M datë 21.09.1992 “Për njohjen e shkallës së ruajtjes dhe gjendjes e dokumentacionit të ish ministrisë së Punëve të Brendshme”, ky ishte hapi i parë i domosdoshëm për të arritur në të ardhmen të hapja e dosjeve. Një numër i madh dosjesh janë asgjësuar në bazë të ligjit 55 (Ligji nr. 7380 datë

08.05.1990) duke konsideruar të pa nevojshme nga qeveritarët e asaj kohe. Në një nga debatet në mediat tona televizive drejtori i Sigurimit Shtetëror Fatos Klosi, u shpreh qartë se dosjet mund të hapen por një numër i madh i tyre mund të jenë eliminuar.

“Zhurma” për hapjen e dosjeve jo pa qëllim është rindezur tani për publikun, ndërkohë që zgjedhjet lokale janë fokusi kryesor i partive politike. Fitimi i elektoratit duke shfrytëzuar arritjet në nivel parlamentar ka qenë gjithmonë pjesë e politikbërjes në Shqipëri. Deklarata nga Z. Rama me 22 Nëntor në inaugurimin e BUNKART për hapjen e dosjeve, ishte rifillimi i këtij debati “të vjetër”. Hapja e dosjeve çuditërisht është propozim i Ministrisë së Mirëqenies, kurse zbardhja e drejtësisë mbi çështjet dhe problematikat e sigurimit të shtetit në kohën e komunizmit duhet të zgjidhet nga Ministria e Drejtësisë, dhe nëse dikush duhet të përfshihej në këtë proces është Ministria e Brendshme, ku ruhen dhe dosjet në arkiva. Pikëpyetje ngrihet mbi iniciativën dhe “tendencën me forcë” që ka MMRS-ja për këtë çështje dhe përfitimet që mund të vinin nga ky proces?! Ministri Veliaj shprehet se; “hapja e dosjeve dhe lustracioni do të bëhet në bazë të modelit gjerman”. Gjermania prej 25 vitesh vijon procesin e hapjes së dosjeve të STASS-it. Por ne nuk jemi në situatën e njëjtë të Gjermanisë, e cila në atë kohë qe gjysma e Gjermanisë, pra Gjermania Perëndimore, që ishte “e pastër shpirtërisht”. Kurse në Shqipëri demokracia dhe transparenca janë akoma në nivel tranzicioni.

Domosdoshmërisht hapja e dosjeve është një proces i cili do të ndodhë herët a vonë, pasi ndarja nga e kaluara duke u përballur me të vërtetat është zgjedhja më e mirë për të vazhduar qeverisjen në demokraci të vendit. Por duhet një model specifik nga një grup profesionistësh që njohin qeverinë komuniste dhe demokratike të Shqipërisë

dhe të kenë analizuar të gjitha modelet e ish vendeve komuniste që kanë kryer këtë proces, duke arritur në një model efikas dhe specifik për Shqipërinë.

<http://www.shekulli.com.al/p.php?id=2270>
31

Referime

Hapja e dosjeve

<http://www.oraneës.tv/analiza/mbi-dosjet-hapjen-e-tyre-dhe-lustracionin/>

<http://www.mapo.al/2014/11/hapja-e-dosjeve-te-sigurimit-ligji-shkon>

<http://www.top-channel.tv/neë/tv/videot.php?id=54355>

<http://www.shekulli.com.al/p.php?id=230309>

<https://www.youtube.com/ëatch?v=QHUzËRIc1SQ>

Punësimi dhe Buxheti 2015

<http://www.oraneës.tv/ora-english/instatthere-ëas-an-increase-of-unemployment-in-the-last-quarter-of-2014/>

<http://www.financa.gov.al/al/buxheti/buxheti-ne-vite/buxheti-2015> , Tabela nr. 1

Reforma e Pensioneve

<http://acp.al/neës/723/Pensionet,-ja-kategorite-qe-do-te-marrin-29,700-deri-ne-34-mije-leke-ne-muaj/>

<http://www.panorama.com.al/ndryshon-skema-pensionet-rritja-e-moshes-nis-ne-2015/>

<http://www.mapo.al/2014/11/projektbuxheti-12-milione-usd-per-rritjen-e-pensioneve-2015>

<http://www.shekulli.com.al/p.php?id=231564>

<http://www.shekulli.com.al/p.php?id=231344>

MINISTRIA E MJEDISIT

Flutura GJANA, BSc

1-Sëmundja e procesionares.

Sëmundje që prej 20 vitesh ka dëmtuar shumë sipërfaqe pyjore, larva e së cilës e than tërësisht pishën. Më 18 shkurt u nis një projekt për trajtimin e saj dhe aktualisht puna në terren po vazhdon. Për t'u njohur më nga afër me procesin e luftimit të sëmundjes së procesionares Ministri Lefter Koka dhe Kryeministri Edi Rama më 17 mars kanë inspektuar rrethin e Elbasanit, ndërsa deputeti Taulant Balla me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit kanë vizituar rrethin e Librazhdit.

Ndërkohë në qarkun e Kukësit nga kjo sëmundje janë prekur qindra hektarë me pishë të zezë, sipërfaqe e cila po shkon duke u rritur dhe Ministria e Mjedisit nuk ka akorduar asnjë fond të posaçëm për këtë rast. Dëmet janë shtrirë në pyjet e Kukësit, Hasit dhe Tropojës dhe përhapja ka arritur nga 800 deri në 1 mijë hektarë. Në qarkun e Kukësit rrezikohen 10 mijë hektarë nga kjo sëmundje që pengon zhvillimin dhe mund të sjellë zhdukjen fare të kësaj bimësie. Specialistët e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Kukës kanë hartuar një projekt për dezinfektimin e këtyre sipërfaqeve por edhe pse nga qeveria është konsideruar emergjencë kombëtare, për qarkun e Kukësit nuk ka asnjë investim.

2-Koncesioni për plehrat e Elbasanit.

Më 16 mars kanë nisur punimet për ndërtimin e impiantit të mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit, një investim prej 21.6 milionë Eurosh. Miratimi i lejes së ndërtimit u bë që më 27 janar. Pavarësisht gjithë propagandës për të mirat që do të sjellë ndërtimi i këtij impianti, si zgjidhje të problemit të trajtimit të mbetjeve urbane dhe shndërrimit të tyre në energji, ngrihen pikëpyetje për kompaninë private që do të investojë për plehrat e Elbasanit. Në media përmendet që do të jetë një kompani

italiane, e cila do të kryejë punimet, ndërsa realisht rezulton që leja është dhënë për kompaninë "Albtek Energy Sh.p.k".

Dyshimet vazhdojnë për këtë kompani. Është e habitshme që emri i saj nuk u përmend as gjatë përrurimit, as në artikullin e Ministrisë së Mjedisit. Me një kërkim të thjeshtë në website-in e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit gjetëm të dhëna për subjektin "Albtek Energy". Kompania është krijuar më 10 korrik të vitit 2014, pra vetëm 5 muaj para se të firmoset koncesioni. Fondet e deklaruara të saj janë 100.000 lekë dhe rezulton që kjo kompani nuk ka asnjë përvojë në projekte të tjera. Si mund të merret vendimi për të dhënë një koncesion pa kryer fillimisht një studim mjedisor, i cili është shumë i rëndësishëm për të analizuar sasinë dhe llojin e gazrave që do të çlirohen në atmosferë. Aksioneres së kompanisë në fjalë, i lindi ideja për të hapur një biznes krejt papritur vetëm në korrik të 2014-ës dhe "fati" bëri që brenda 5 muajve, vetëm falë "kapitalit" dhe "përvojës" me Vendim të Këshillit të Ministrave të marrë me koncesion asgjësimin e plehrave të Elbasanit.

Referime

<http://www.mjedisi.gov.al/al/newsroom/lajme/projekt-i-ri-kunder-procesionares-se-pishes&page=2>

<http://www.mjedisi.gov.al/al/neesroom/lajme/kryeministri-rama-dhe-ministri-koka-inspektojne-operacionin-kunder-procesionares&page=1>

<http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=294940>

http://www.planifikimi.gov.al/sites/default/files/P_%20Vendimi%201_Inceneratori_MM.pdf

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Megi LLUBANI, MSc

Ministria e Punëve të brendshme e nisi muajin mars me hapjen e Zyrës së Shërbimit Unik pranë Komisarariatit nr. 1 në Tiranë. Në fjalën e tij inauguruese Ministri Tahiri theksoi se “ Zyra e Shërbimit Unik... i jep sigurisht një zgjidhje definitive shërbimeve cilësore që Policia e Shtetit jep ndaj qytetarëve, siç i jep një zgjidhje definitive evitimit maksimal të praktikave korruptive që kanë qenë deri dje. Dhe nga ana tjetër, ky është një shembull mjaft i mirë për suksesin që mund të arrijmë nëpërmjet bashkëpunimit me partnerët tanë dhe mbi të gjitha nëpërmjet bashkëpunimit me partnerët privatë.”¹ Në një paragraf të vetëm përmenden tre elementë mjaft të rëndësishëm, siç janë: përmirësimi i shërbimit ndaj qytetarëve, eliminimi i korrupsionit në radhët e policisë dhe përmirësimi i partneritetit publik-privat. Ndërkohë që i pari është i vetëkuptueshëm për shkak të shkurtimit të kohës së shërbimit dhe modernizimit të tij, nuk është po aq e qartë se çfarë nënkupton ministri me partneritet publik-privat, meqë ai në asnjë moment nuk sqaron se nga kush dhe si është financuar kjo zyrë e re. Po ashtu, pavarësisht dëshirës së mirë për ta besuar plotësisht deklaratën e tij, nuk është menjëherë e kuptueshme se si kjo zyrë do ta eliminojë “në maksimum” korrupsionin, pasi ministri dështon të konsiderojë faktorin njerëzor në deklaratën e tij. Për të mbetur te tema e korrupsionit, portali online i lançuar pak kohë më parë (si një tjetër kërkesë e BE-së) përveç

¹ Artikulli i plotë mund të aksesohet në:
<http://www.punetebrendshme.gov.al/al/te-rejat/lajme/celet-zyra-per-sherbimin-unik-ne-komisariat-in-nr-1-ne-tirane-video&page=1>

zhurmës fillestare se do të përballej me fenomenin e korrupsionit në rrënjët e tij, duket se nuk ka arritur ndonjë gjë konkrete. Për më tepër në vetë portalin nuk ka transparencë për rastet e raportuara, trajtuara dhe proceduara më tej në rrugë ligjore.

1- Rendi...ose mungesa e tij

Sikundër është vënë në dukje edhe në raportin e muajit shkurt, rivendosja dhe sigurimi i standardeve evropiane dhe ndërkombëtare të rendit dhe sigurisë në Shqipëri përbëjnë shtyllat themeluese të programit të Partisë Socialiste, tashmë program i qeverisë shqiptare prej më tepër se 1 viti. Më konkretisht, premtohet “ Normalizim i situatës së rënduar të rendit publik, që në vitin e parë të qeverisjes. Ndoshta premtimi vlente vetëm për vitin e parë, jo ato në vijim? Për ta ilustruar këtë skepticizëm është kryer një monitorim i kronikës në media të ndryshme për të regjistruar situatën e rendit dhe sigurisë në Shqipëri. Duke marrë parasysh që mund të ketë raste të tjera të pa raportuara, shifrat e renditura shkurtimisht më poshtë reflektojnë prirjet shqetësuese të shkeljes së ligjit dhe mungesës së sigurisë në Shqipëri. Vetëm në muajin mars janë vëzhguar gjithsej rreth 114 raste krimesh të ndryshme, që variojnë nga grabitjet me armë, aksidentet rrugore, vënie tritoli dhe vrasje e deri tek arrestimet për korrupsion e shpërdorim detyre. Nga një përlllogaritje e thjeshtë rezulton se në pjesë të ndryshme të vendit ndodhin mesatarisht 4 krime në ditë (shifër që sipas të dhënave zyrtare mund të jetë edhe më e madhe).

Një prej fenomeneve më problematike, që ka ngritur me të drejtë shqetësime të mëdha për gjendjen e rendit dhe të sigurisë në Shqipëri është vënia, posedimi apo alarmi për vënie tritoli (bombash etj.). Vetëm këtë muaj ka patur 8 raste të vënies së tritolit në automjete të ndryshme (me pasoja shpesh plagosje, por jo vdekje) dhe 9 raste të tjera për alarm për

vendosjen e lëndës plasëse, që në shumicën e rasteve ka rezultuar i rremë. Përtej dëmeve të shkaktuara, pasiguria dhe frika që ka prodhuar kjo valë shpërthimesh prej mëse dy muajsh mjafton për të hedhur poshtë pretendimet e shpeshta të Ministrisë së Punëve të Brendshme për punën e mrekullueshme që është bërë për uljen në maksimum të krimeve.

Pjesa tjetër e kronikës së monitoruar përfshin:

- 1- Grabitje të armatosura – 13 raste
 - 2- Arrestim për posedim droge – 13 raste
 - 3- Arrestim për prostitucion/trafikim – 3 raste
 - 4- Dhunë e formave të ndryshme ndaj grave – 6 raste
 - 5- Aksidente rrugore – 24 raste
 - 6- Vrasje – 10 raste
 - 7- Plagosje – 7 raste
 - 8- Arrestim për korrupsion/shpërdorim detyre – 10 raste
 - 9- Marrje peng – 2 raste
 - 10- Arrestim për kontrabandë – 3 raste
 - 11- Mashtrim financiar – 3 raste.²
- 2- Iniciativa...jo vetëm estetike

Në datë 5 mars Kuvendi i Shqipërisë miratoi rezolutën "Për parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri". Përtej gabimeve të shumta drejtshkrimore të relacionit (!) iniciativa në vetvete duhet përshëndetur pasi ngre një problematikë mjaft shqetësuese që kërkon qasje të institucionalizuara.³ Fatkeqësisht, një ndër

² Rastet i referohen monitorimit të Balkanweb online:
<http://www.balkanweb.com/site/>

³ Rezoluta dhe materialet shoqëruese mund të lexohen online në faqen e Kuvendit të Shqipërisë në linkun në vijim:

http://www.parlament.al/ëeb/5_Mars_2015_Rezolute_Per_parandalimin_e_fenomenit_te_gjakmarrjes_ne_Shqipëri_19446_1.php si edhe botuar në fletoren zyrtare në datë 18 mars:
http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/38-2015.pdf.

shprehjet më së shumti të përdorura nga studiuesit në Shqipëri është se ligjet dhe politikat në këtë vend duken mirë në letër por çalojnë në zbatim, aq sa procesi i integritetit është konsideruar ndonjëherë thjesht si përkthim dhe përshtatje e ligjeve me ato të Bashkimit Evropian, pa menduar dhe planifikuar zbatimin e tyre. Kjo duket qartë edhe nga një paragraf i raportit mbi projektrezolutën sipas të cilit "Nënkomisioni "Për të drejtat e njeriut", në një mbledhje të përbashkët me Nënkomisionin "Për çështjet e të Miturve, Barazisë Gjinore dhe Dhunën në Familje" dhe deputetë të qarqeve ku problemi i vrasjeve për hakmarrje dhe gjakmarrje përbën një shqetësim, mori në shqyrtim Raportin e Veçantë të Avokatit të Popullit "Për gjakmarrjen", duke përmbushur edhe një nga kërkesat e Progres raportit të Komisionit Evropian për vitin 2014". Një tjetër shembull ilustrues i kësaj të fundit është fakti që 10 vite më parë Parlamenti shqiptar aprovoi Ligjin nr. 9389, datë 04.05.2005 "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes", i cili nuk ka funksionuar as edhe një ditë të vetme, sipas raportit të Avokatit të Popullit, por edhe të pasqyruar në vetë rezolutën e miratuar pak ditë më parë.⁴ Me të drejtë Kuvendi ngarkon një sërë institucionesh, ndër to Policia e Shtetit, "që të marrin masa për parandalimin e konflikteve, për zbulimin dhe dërgimin e personave të akuzuar tek organi i prokurorisë, duke forcuar bashkëpunimin me organet homologe dhe me Interpolin për ekstradimin e personave në kërkim ose të dënuar nga gjykatat shqiptare për veprat penale me motive gjakmarrjeje ose hakmarrjeje." Megjithatë mbetet ende për t'u parë nëse iniciativa të tilla ligjore dhe

⁴ "Mosfunksionimi i Këshillit Koordinues për këtë çështje për vite me radhë tregon se fenomeni nuk është adresuar si duhet nga institucionet shtetërore, lidhur me parandalimin dhe zhdukjen e fenomenit." – Marrë nga rezoluta e miratuar në parlament mbi parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri.

institucionale do të adresohen vërtetë sipas kërkesave të parashtruara në rezolutë apo do të duhet të kalojnë edhe 10 vite të tjera për të kuptuar se organet e ngritura dhe të rregulluara me ligj në fakt nuk kanë funksionuar aspak dhe na duhet një tjetër rezolutë për të adresuar këtë problem.

Iniciativa e dytë ligjore e muajit mars që prek punën e Ministrisë së Punëve të Brendshme është Vendimi i Këshillit të Ministrave për Kompensimin për privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të Policisë së Shtetit për shkak të nevojave të punës dhe shërbimit. Vendimi, i ilustruar edhe në media pretendohet se rrit pagesat dhe shpërblimet për këtë kategori (madje edhe paraqiten tabelat e reja të pagesave). Nga një krahasim i VKM-së së vitit 2011 me VKM-në e miratuar në datë 26 mars, mund të arrihet lehtësisht në përfundimin se:

- 1- Pagesa për kompensimin e udhëtimit nuk ka ndryshuar aspak. Në të dyja rastet fillon me 3000 lekë në muaj për largësi nga 36 deri në 60 km dhe shkon 15000 për largësi mbi 200 km.⁵
- 2- Ajo që ka ndryshuar është numri dhe shumëllojshmëria e dokumentacionit që punonjësi i Policisë së Shtetit duhet të paraqesë për përfitimin e këtyre pagesave (duke shtuar me vendimin e ri vërtetim për pronë të paluajtshme në pronësi të tij/saj dhe vërtetim nga ALUIZNI që kjo pronë e paluajtshme është e legalizuar ose në proces legalizimi – nuk është e qartë përse

një dokumentacion i tillë shtesë është i nevojshëm dhe çfarë qëllimi i shërben).

- 3- Ai që ka ndryshuar ndjeshëm është kompensimi i bashkëshortit/bashkëshortes në rast se punonjësi i policisë transferohet, çka rezulton në humbjen e marrëdhënies së punës për të parin. Ndryshimet nga VKM e vitit 2011 janë si më poshtë:
 - a. Nëse në VKM e vitit 2011 bashkëshorti/bashkëshortja përfitonte 50% të pagës minimale nëse kishte **3 muaj deri në 1 vit** eksperiencë pune, me vendimin e ri ai/ajo përfiton 50% të pagës minimale nëse ka **mbi 1 vit** eksperiencë pune.
 - b. Nëse në vendimin e vitit 2011 bashkëshorti/bashkëshortja përfitonte 100% të pagës minimale kur ky i fundit kishte 1 deri në 10 vjet eksperiencë pune, me vendimin e ri kjo pjesë është hequr dhe bashkëshorti/bashkëshortja përfiton 100% të pagës mesatare mujore të vitit të fundit të punës vetëm nëse ka **mbi 10 vite**. Kjo në terma absolutë nënkupton se pagesat për këtë kategori do të jenë më të vogla, jo më të mëdha.
 - c. Së fundi duhet theksuar se masa 100% e pagës për bashkëshortët me mbi 10 vite eksperiencë pune kufizohet nga fakti që kjo shumë nuk duhet të jetë më e madhe se 150% e pagës minimale në rang vendi. Kjo do të thotë se sado të ketë qenë paga e këtij të fundit, ajo nuk mund të jetë më e lartë se 33 000 lekë (meqë paga minimale e re është 22 000 lekë).
 - d. Së fundi periudha e përfitimit të kësaj pagese shkurtohet nga 15 vite në vendimin e vitit 2011, në 7 vite në VKM-në e 2015.

⁵ Vendimi i Këshillit të Ministrave të 2015
http://www.punetebrendshme.gov.al/files/neës_files/Vendimi_per_KOMPENSIMIN_P%C3%8BR_PRIVACIONET_DHE_HUMBJET_Q%C3%8B_I_SHKAKTOHEN_PUNONJ%C3%8BSIT_T%C3%8B_POLICIS%C3%8B_S%C3%8B_SHTETIT,_P%C3%8BR_SHKAK_T%C3%8B_NEVOJAVE_T%C3%8B_PUN%C3%8BS_DHE_T%C3%8B_SH%C3%8BRBIMIT.pdf
që shfuqizon Vendimin e Këshillit të Ministrave 9.2.2011:
http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2011/PDF-2011/40-2011.pdf

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Sokol KONDI, MSc

1- Anomalitë me ligjin e ri për shërbimin e jashtëm

Më 20 mars Kuvendi i Shqipërisë miratoi një ligj të ri "Për Shërbimin e Jashtëm", i cili përpara miratimit të tij kaloi me debate të ndezura në Komisionin e Jashtëm të Parlamentit, i kundërshtuar nga dy deputetë të mazhorancës, mes të cilëve edhe vetë kryetarja e Komisionit. Sidoqoftë, kur erdhi fjala për të votuar nuk pati firo votash, me përjashtim të një abstenimi vetëm për njërin nen të ligjit, çka gjithsesi nuk përbëri asnjë pengesë që ligji të kalonte me kuorumin e nevojshëm.

2- Përpjekje për t'i diktuar ushtrimin e funksioneve Presidentit

Në ligjin e ri, bie në sy një afat kohor prej 20 ditësh që i caktohet Presidentit të Republikës për të emëruar ambasadorët që i propozohen nga Kryeministri. Edhe pse në ligjin e vjetër një afat i tillë nuk ekzistonte, parashikimi i kësaj mase në ligjin e ri jo domosdoshmërisht i shmang përplasjet e mundshme që mund të lindin midis qeverisë dhe presidentit lidhur me emërimin e kandidatëve për ambasadorë. Në fakt, si një organ i pavarur, Kushtetuta i jep Presidentit të drejtën e mos mbajtjes së përgjegjësisë për aktet e kryera në ushtrim të funksionit të tij. Çka, e përkthyer ndryshe, do të thotë se presidentit mund të vazhdojë të mos "i hyjë gjemb në këmbë", sikurse mund të dëshironte qeveria, nëse vazhdon që për arsye subjektive të mos i dekretojë emërimet e kandidatëve për ambasadorë, në përputhje me procedurat e parashikuara nga ligji i ri për shërbimin e jashtëm. Është e vërtetë se po në Kushtetutë parashikohet se një nga funksionet e presidentit është emërimi i ambasadorëve, me propozim të

kryeministrit, por nga vetë fryma që kushtetuta i njeh presidentit si organ i pavarur, ajo nuk ia dikton atij se si ta ushtrojë këtë funksion, duke e lënë tërësisht në diskrecionalitetin e kreut të Shtetit. Aq më pak këtë funksion presidentit mund t'ia diktojë qeveria. Do apo nuk do politika, presidenti është një organ i pavarur shtetëror.

3- Licencë pro nepotizmit?

Sidoqoftë, pika më e përfolur dhe e debatuar e ligjit të ri ka qenë heqja e kuotës prej 20 përqindësh e diplomatëve jo të karrierës që mund të drejtojnë përfaqësitë diplomatike (ambasadat) të Shqipërisë. Ligji i ri nuk parashikon kufizime për ambasadorët e rinj që nuk vijnë nga rradhët e shërbimit të jashtëm. Si kriter për këta të fundit është caktuar që të kenë të paktën 10 vite përvojë në fushën e politikës së jashtme, marrëdhëniet ndërkombëtare, marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare ose të së drejtës ndërkombëtare, ndër të cilat tre vite në pozicione drejtuese. Kjo do të thotë se në rastin më të mirë, një pedagog i së drejtës ndërkombëtare rreth të 40-tave, që ka qenë tre vite dekan ose shef departamenti, mund të emërohet ambasador. Në rastin e ndërmjetëm, mund të emërohej ndonjë sipërmarrës që për shembull ka mbi dhjetë vite që bën tregti me Kinën (sa për të cituar një vend). Por në rastin më të keq mund të emërohet edhe ndonjë mik apo i afërm i funksionarëve të lartë të MPJ-së, që gjykohet subjektivisht se i përmbush këto cilësi. Subjektivisht pasi ligji përcakton se vetë Ministria bën përzgjedhjen e kandidatëve. Po Ministrinë, kush e gjykon nëse e shkel normën ligjore, vetë Ministria? Sipas ligjit po, sa për të krijuar një ide.

Në ligjin e vjetër kuota e ambasadorëve nga jashtë sistemit ishte e kufizuar, pavarësisht se shkelej me të dyja këmbët. Por në vend që të ndreqej kjo anomali, u shkua edhe më tutje, duke e hequr

tërësisht kuotën, pra duke i dhënë vetës licencën për ta çdiplomatuar diplomacinë. Duke patur parasysh se qeveria aktuale e akuzonte për nepotizmin e thellë në diplomaci qeverinë e mëparshme, ligji i ri nuk lë aspak përshtypjen se ka për qëllim ta profesionalizojë sistemin, përkundrazi. Një prirje e tillë mund të shihet edhe si një pranim i dështimit apo paaftësisë së shërbimit të jashtëm për të nxjerrë diplomatë karriere në lartësinë e duhur. Në fakt, nëse sistemi i diplomacisë do të ishte efikas, nuk do të kishte arsye përse të synoheshin njerëz nga jashtë tij. Në vend që të përforcojë strukturat dhe kapacitetet e saja, MPJ ka parapëlqyer të peshkojë gjetkë. Një dobësi e tillë është pranuar edhe nga vetë ministri Bushati, jo me ndonjë pikëllim të madh, por përkundrazi me krenarinë e prurësit të një gjetjeje apo risie. Në fakt, në një deklaram të janarit 2014, ministri hidhte idenë e tij se nga jashtë sistemit ka njerëz që janë në gjendje ta bëjnë më mirë punën e promovimit të vendit. Kjo bindje, për shembull, do ta ketë frymëzuar ministrin kur ka propozuar për ambasadore në Holandë një përkthyes, në kundërshtim jo vetëm me ligjin e vjetër të shërbimit të jashtëm, por edhe me frymën e të riut, që supozohet se dikasteri i jashtëm kishte nisur ta përpunonte që asokohe.

4- Ku është meritokracia?

Ligji i ri saktëson se për t'u bërë ambasador, duhet që diplomati i karrierës të gëzojë të paktën gradën "Këshilltar". Pra këshilltari i një ambasade të caktuar mund të emërohet direkt ambasador. Këtu nuk mund të flitet për një meritokraci të plotë. Në një rast të tillë, i bie që të diskriminohen diplomatë që mbajnë gradat "Ministër Këshilltar", "Ministër Fuqiplotë" dhe "Ambasador", grada të cilat janë të një rangu më të lartë se "Këshilltari". Nuk kuptohet se përse ligji ka vendosur një hierarki ndërmjet gradave, kur më pas përcakton se edhe një gradë më e ulët

mund të vlejë më shumë se një gradë më e lartë, pra kur edhe një këshilltar mund të caktohet ambasador. Megjithatë, sikurse cituam më lartë, për të shmangur "probleme" të tilla MPJ e ka gjetur zgjidhjen: mund të emërohet dikush nga jashtë sistemit!

5- Rasti i Konsulles së Përgjithshme në Selanik

Është raportuar nëpër media me shumë zhurmë fakti se konsullja e përgjithshme në Selanik Pavlina Ylli (Evro), ka rreth dy dekada që jeton në Greqi dhe ka edhe kartë identiteti të vendit fqinj. Megjithatë, në asnjë rast nuk është shkruar apo raportuar që zonja në fjalë të ketë hequr dorë nga shtetësia shqiptare. Duke qenë se ligjet e vendit e lejojnë mbajtjen e dyshetësisë, për sa kohë nuk provohet se Znj. Ylli ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare, pasja apo marrja e një shtetësie të dytë nga ana e saj pa hequr dorë nga shtetësia e parë, nuk përbën ndonjë lajm kaq të zëshëm, sikurse janë munduar të trumbetojnë disa media.

Referime

<http://www.ambasadat.gov.al/netherlands/sq/ambasadore-adia-saqiqi>
<http://www.panorama.com.al/skandali-i-bushatit-konsullja-ne-selanik-me-letra-greke/>
http://www.parlament.al/web/pub/procesverbal_9_03_2015_21476_1.pdf
http://time.ikub.al/cd8c3048a6/1f1ba4347c01f4da093f2b49605e0d28/Lajm_Bushati-70-te-ambasadoreve-u-ka-mbaruar-mandati-Reforme-ne-diplomaci.aspx
Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Ligji Nr.9095, date 3.7.2003

Ligji nr. 23/2015

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Adela DANAJ, BA

1- EC-135, ndihma e shpejtë për transportin mjekësor. "Dashtë Zoti nuk sëmureni në Shqipëri"

Shërbimi mjekësor në Shqipëri vazhdon të mbetet një nga sfidat më të mëdha të çdo qeverie që vjen në pushtet. Ky raport nuk ka si qëllim të sjellë në vëmendje arsye të përse këto sfida vazhdojnë të jenë konsistente çdo vit, çdo ditë e çdo minutë, pasi në këtë rast niveli i analizës do të duhej të shtrihej në disa dimensione dhe një raport i vetëm do ta kishte thuar se të pamundur të dilte në disa përfundime të rëndësishme. Por, duket se ministria aktuale e qeverisë në pushtet po tenton të bëjë një hap përpara kundrejt këtyre sfidave. Më datë 25 Mars, nga Ministria e Shëndetësisë na erdhi lajmi se shërbimeve spitalore shqiptare ju shtua një helikopteri i ri për shërbimin e transportit mjekësor. Menjëherë pas këtij lajmi, ministri Beqaj u prononcua duke thënë: *"Fuqizojmë dhe modernizojmë kapacitetet në zbatim të angazhimit të Programit qeverisës për shërbimin e urgjencës mjekësore"*.

Gjithashtu, me këtë rast u iniciua organizimi i një ceremonie në mjediset e kësaj Njësie, që përkoi edhe me 20-vjetorin e krijimit të saj (23/3/1995-Flota e Njësies së Transportit Mjekësor me Helikopter-NJTMH). "Ne jemi zotuar se do të ngremë një Shërbim Kombëtar të Urgjencës Mjekësore, i cili do të mund të sigurojë prani të shpejtë e profesionale në të gjithë territorin e vendit, duke vendosur standarde të njëjta në të gjitha qendrat pritëse, duke iu përgjigjur nevojave të ndryshueshme gjatë stinëve të vitit, për të ofruar kujdes shëndetësor në sëmundshmëri dhe trauma":- tha midis të tjerash në fjalën e tij Ministri.

Nuk ka dyshim që ky është një lajm shumë i mirë për të gjitha ato familje shqiptare që vuajnë dyerve të spitaleve dhe shpresojmë që ky helikopter të mos shndërrohet në "mollë sherri". Kjo e thënë për një arsye fundamentale:

2-Do të zbatohet parimi i barazisë për ata të cilët do të kenë nevojë urgjente transporti?

Gjithashtu, këtij diskutimi ky raport i shkon më tej duke shtruar pyetjen: Edhe sa do të zgjasë ky model, kur sa herë vjen diçka e re, shteti mban një event special dhe ministri ngre dollin? Duhet mbajtur një qëndrim përfundimtar, ose jemi vend evropian, ose do të vazhdojmë të ndjekim këto modele të turpshme, që e bëjnë Shqipërinë të ndjehet gjithmonë e më shumë nevojtare dhe e pashpresë. Mos ndoshta do të ishte më mirë që shpenzimet e eventit për t'i uruar mirëseardhjen helikopterit në fjalë, ministri t'i përdorë për ilaçet e munguara në spitale??

Ndërkohë që Ministria e Shëndetësisë vazhdon ta reklamojë punën e saj, Z. Donald Lu, Ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, ka pohuar: "Dashtë Zoti nuk sëmureni në Shqipëri". Kjo për faktin e thjeshtë se qendrat shëndetësore nuk kanë kushtet e duhura për t'i shërbyer njerëzve. Fatkeqësisht ky pohim erdhi në kuadër të prezantimit të rezultateve të studimit "Monitorimi i Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor Parësor në Shqipëri", më 10 Mars 2015, organizuar nga Ministria e Shëndetësisë në lidhje me situatën në Qendrat Shëndetësore në Shqipëri, ku ishin marrë në monitorim rreth 550 Qendra Shëndetësore të Kujdesit Parësor (QSHKP). Ministria në fjalë një ditë më vonë e bëri publik lajmin në faqen zyrtare të Ministrisë, por nuk citoi në asnjë moment fjalët e ambasadorit. "Ministri duhet t'i përkthejë këto shifra në punë konkrete për përmirësim", është shprehur

ambasadori amerikan Donald Lu, vërejtje që nuk pasqyrohet gjëkund në deklaratën e ministrisë. Duket se pavarësisht fjalëve negative, ministri Beqaj nuk ka ndërmend t'i marrë parasysh këshillat e ndërkombëtarëve, sidomos të atyre që kanë investuar dhe vazhdojnë të investojnë në shëndetësinë shqiptare, siç është USAID.

3- Një tjetër borxh në "portofolin" e qeverisë Shqiptare

Ministri i Financave, z. Shkëlqim Cani ka nënshkruar më datë 24 Mars Marrëveshjen e huasë me Bankën Botërore. Marrëveshja siguron financimin e nevojshëm për Projektin e Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor në Shqipëri, nëpërmjet një huaje në shumën 32.1 milionë euro. Projekti do të bashkëfinancohet gjithashtu nga Qeveria Shqiptare në vlerën 4 milionë euro, shumë e cila do të shërbejë për financimin në masën e 37%, të punimeve të rehabilitimit fizik dhe përmirësimit të infrastrukturës spitalore, si dhe kontributin në pagesat e detyrimeve tatimore të lidhura me Projektin.

Projekti i Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor kontribuon në: (i) forcimin e administrimit dhe qeverisjes në spitalet publike; (ii) përmirësimin e mënyrës së financimit shëndetësor; (iii) zbatimin e sistemeve të informacionit për të përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor në Shqipëri.

Huaja e akorduar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BB), ka termat e mëposhtëm:

- Shuma: 32,100,000 Euro
- Tarifa Front-end: 0.25 % e shumës së huasë
- Tarifa e Angazhimit: 0.25% në vit mbi balancën e patërhequr të huasë
- Maturimi: 22.5 vjet, nga të cilat 7 vjet pa pagesë principali

- Interesi: Norma Referencë (EURIBOR 6-mujor) plus Marzhën e Pandryshueshme (1%)

Projekti do të zbatohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe parashikohet të përfundojë në 28 Shkurt 2021.

Ajo që duhet theksuar është fakti se Ministria e Shëndetësisë deri tani, nuk ka publikuar asnjë plan paraprak konkret se si do të shpërndahen këto të ardhura. Për më tepër nuk ka realizuar asnjë studim të mëparshëm, të paktën nuk ka publikuar asnjë të tillë për të parë se cilët sektorë të shëndetësisë kanë nevojë urgjente për ndërhyrje. Lajmi i Ministrit të Financave nuk duhet të interpretohet me tone pozitive deri në momentin që ky borxh numërohet si një borxh më shumë në portofolin e qeverisë shqiptare.

Referime

<http://www.shendetesia.gov.al/al/neesroom/lajme/helikopter-i-ri-per-sherbimin-e-transportit-mjekesor>

<http://www.shendetesia.gov.al/al/neesroom/lajme/kzln-publikon-studimin-kerkimor-per-550-qendra-shendetesore-ne-vend>

<http://www.lapsi.al/lajme/2015/03/11/pse-ministria-e-sh%C3%ABndet%C3%ABsis%C3%AB-fshehu-kritikat-e-ambasadorit-amerikan>

<http://www.shendetesia.gov.al/al/neesroom/lajme/nenshkruhet-huaja-32-1mln-me-banken-boterore-per-permiresimin-e-sistemit-shendetesor>

MINISTRIA PËR ÇËSHTJET VENDORE

Brenton KOTORRI, BA

1- Stopkorrupsionit.al një sukses i paverifikueshëm.

Ministria për Çështjet Vendore, ka si prioritet komplementar edhe luftën kundër korrupsionit. Pas promovimit të bujshëm të fillim-shkurtit të këtij viti, kjo ministri publikoi disa të dhëna statistikore. Përpara se të marrim në shqyrtim këto të dhëna, le të shohim për një moment dy elemente shqetësuese të urdhrat kryeministror për miratimin e rregullores së Stopkorrupsionit.al.

Së pari, në pjesën e tretë të këtij urdhri, titulluar Regjistrimi i praktikave korruptive të denoncuara, në pikën a), thuhet: Qytetarët mund të bëjnë denoncimin e rasteve korruptive vetëm në rrugë elektronike, nëpërmjet aksesimit të kanalit të komunikimit, që është Faqja Unike e Denoncimit të Korrupsionit. Në pamje të parë, dikush mund të thotë "sigurisht që për të aksesuar një website rruga elektronike do të përdoret". Mirëpo nuk është ky shqetësimi parësor. Ajo që kryeministri dhe ministri përkatës marrin si të mirëqenë është se të gjithë qytetarët e këtij vendi kanë akses në një pajisje elektronike që është e lidhur me internet. Edhe nëse i besojmë për një moment kësaj hipoteze, na del përpara një dilemë disi ideologjike: A e kanë për detyrë qytetarët që të zotërojnë një pajisje elektronike të lidhur me internet, ndërkohë që shteti nuk ua mundëson këtë falas? Nëse përgjigja është jo, atëherë duhet theksuar se kjo iniciativë do t'i lehtësojë jetën vetëm një shtrese të caktuar qytetarësh duke marginalizuar kështu të gjithë ata, që nuk zotërojnë një PC, Smartphone, dhe që nuk i kanë këto të lidhura me internet, apo që në rastin më të keq nuk dinë t'i përdorin.

Së dyti, në nenin 8 të kësaj rregulloreje, pika 1, thuhet: Institucionet përgjegjëse (institucionet e varësisë të Kryeministrit), ministrisë përkatëse, Prefekti i Qarkut, shqyrtojnë denoncimin e kryer sa më shpejtë të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 ditë nga dita e dorëzimit të saj. Kjo do të thotë se me gjithë përgjegjshmërinë dhe profesionalitetin e stafit të kësaj ministrie, një çështje e denoncuar mund të zvarritet deri në 30 ditë. Le të mendojmë për një moment objektivisht dhe le të marrim disa raste denoncimesh. Rasti 1- A mundet një qytetar ta denoncojë korrupsionin teksa aplikon për asistencë sociale dhe i ka fëmijët të paushqyer? Rasti 2- A mund të presë 30 ditë një i vetëpunësuar që me kredi bankare ose borxhe ka vendosur të bëjë tregti dhe denoncon ryshfetin që i kërkojnë në doganë? Pra ai duhet të qëndrojë 30 ditë peng në zonën midis dy policive? Dhe rasti 3 - Si mundet të presë 30 ditë një i sëmurë që ka nevojë për operacion, teksa i afërmi i tij i dëshpëruar ka vendosur të përdorë stopkorrupsionit.al ? Sigurisht që unë përmenda Administratën Publike, Policinë dhe Shëndetësinë si tre sektorë klasikë të rasteve të korrupsionit, mirëpo shumë lehtë mund të imagjinojmë nga një rast për çdo situatë.

Propozimi ynë në këtë rast do të ishte jo thjesht ndryshimi i këtij afati, por delegimi i autoritetit për te verifikuar ngjarjet në terren, tek Njësitë Policore Lokale të Krimin Ekonomik.

Në datën 23 mars, ministria publikoi në faqen e vet online disa statistika rreth portalit www.stopkorrupsionit.al. Ku në shifra të përgjithshme deklarohet se janë marrë 4256 raste denoncimi prej të cilave janë mbyllur 2086 raste, dhe janë refuzuar 412 raste. Këto statistika nuk janë shoqëruar me sqarime përkatëse. Përshebull, nuk është sqaruar nëse rastet e mbyllura kanë rezultuar në akuza të pabaza, apo janë vërtetuar. Nuk është

sqaruar as nëse këto raste kanë çuar në paralajmërimin, pezullimin apo përjashtimin e ndonjërit prej 2086 nëpunësve (minimalisht) të përfshirë në këto raste. Gjithashtu, mbetet e pasqaruar edhe pse 412 raste janë refuzuar që të merren në shqyrtim. Këto pyetje, stafi i APPA do t'i adresojë zyrtarisht në vazhdim bazuar tek e drejta e informimit publik.

2- Trajnim për vetëm 36 nëpunës.

Dita e fundit e muajit ka shërbyer edhe si dita e përfundimit të trajnimit për 36 punonjës të prefekturave të Shqipërisë rreth Reformës Territoriale Administrative që do të hyjë në fuqi pas zgjedhjeve lokale të 21 qershorit. Ky trajnim, bazuar tek axhenda e trajnimit, nuk ka patur të integruar asnjë testim apo formë tjetër për të vërtetuar nëse këta 36 punonjës nga e gjithë Shqipëria i kanë përvetësuar apo jo dijet teknike me të cilat do të qeveriset lokalisht Shqipëria në vazhdim.

Referime

<http://www.ceshtjetvendore.gov.al/al/prioritetet/lufta-kunder-korrupsionit>

<http://www.ceshtjetvendore.gov.al/al/newroom/lajme>

www.stopkorrupsionit.al

MINISTRIA E INOVACIONIT DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE

Blerina LLALLA, MSc

1- Historia e një Gjobe Dixhitale

Platformat dixhitale në Shqipëri nuk përbëjnë ndonjë risi të veçantë për publikun pasi janë prezente nëpërmjet subjekteve private tashmë prej një dekadë e ca, por kur përmendim RTSH-në, këtu kemi të bëjmë gjithnjë me një risi pasi bëhet fjalë për një institucion publik të një rëndësie të veçantë në vendin tonë.

Sipas detyrimit kryesor në bazë të vendimit të Komunitetit Europian, brenda muajit Qershor 2015 duhet që çdo vend anëtar i Komunitetit Europian të ketë përfunduar me patjetër platformën për dixhitalizimin e televizioneve publike kombëtare, që do të thotë të bëhemi pjesë e një sistemi transmetimi dixhital të unifikuar. Kjo histori nuk i ka fillësat në ditët e sotme, por ajo vazhdon të kthehet në qendër të vëmendjes herë pas here, dhe ende nuk dihet fundi, nëse kjo platformë do të implementohet apo jo në Shqipëri.

Më date 19 Mars të këtij viti u nënshkrua kontrata e shumëpërfolur për dixhitalizimin e RTSH-së ndërmjet tre palëve; Ministres së Inovacionit dhe Administratës Publike Znj. Harito, Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së dhe Drejtorit të Përgjithshëm të kompanisë Rohde & Swarz.

Gjatë fjalës së mbajtur, Ministria Harito theksoi se përfundimi i kësaj etape të rëndësishme mundëson respektimin e afatit kohor të vendosur nga KE për transmetimet audiovizive duke garantuar për qytetarët shqiptarë TV dixhitale pa pagesë. Shqipëria i bashkohet kështu vendeve të rajonit dhe të Europës perëndimore, të cilët e kanë realizuar këtë

proces me sukses.

Po të kthehemi pas në kohë do të kujtojmë se bëhet fjalë për disa vite diskutime, debate publike dhe parlamentare në lidhje me praktikën, teknologjinë, legjislacionin që duhet dhe kushteve të zhvillimit të infrastrukturës së nevojshme etj, por pa rezultat. Çështja mbeti pezull. Sot gjendemi me një kontratë në dorë, dhe një faturë të majme për tu paguar nga shteti ynë në përmbushjen e këtij kriteri dhe kjo vetëm katër muaj përpara përfundimit të afatit të vendosur nga Komuniteti Europian.

A është kjo kontratë një gjobë në duart tona apo një zgjidhje me kosto të shumëfishtë? Në fjalën e saj Ministria Harito shprehet se kjo kontratë shkon në përputhje me vendimin e gjykatës duke i kthyer të drejtën e mohuar nga qeveria e shkuar kompanisë gjermane që ishte ngarkuar për realizimin e këtij procesi. Ndërkohë nga Kryeministri i vendit theksohet se kjo marrëveshje u arrit në kohën e imponimit të teknologjisë dixhitale nga operatorët privatë në Shqipëri, në funksion të gjetjeve të zgjidhjeve të reja dhe sikurse nënvizohet, nga realizimi i këtij procesi do të gjenerohen të ardhura të konsiderueshme, si dhe njëkohësisht do të rritet cilësia e shërbimeve për qytetarët.

Sipas deklaratave dhe kritikave të OSBE-së ndaj qeverisë shqiptare për RTSH-në, theksohet se për dy vite rresht forcat politike parlamentare nuk kanë arritur të miratojnë legjislacionin e duhur, gjë që ka ndikuar në bllokimin e procesit të transmetimeve dixhitale të RTSH-së dhe nuk bëri të mundur që ai të kthehet në transmetues të mirë publik që kontrollohet, është hartuar për publikun dhe financohet nga publiku. Kështu që nuk mund të harrojmë shkaqet e pezullimit të këtij procesi standard europian dhe botëror ku sërish do të na duhet ne taksapaguesve të ndajmë peshën e rradhës të koston financiare.

Fakti është që prej vitit 2007 RTSH-së iu dhanë fillimisht dy frekuenca për të dalë në transmetim dixhital, por për shkaqe të infrastrukturës teknologjike që disponon ky institucion do të duhej shumë punë, investim dhe kosto për të arritur gradualisht gjatë këtyre viteve në një transmetim të platformës dixhitale sipas standardeve të kërkuara. Gjithashtu nga momenti i vendosjes në frekuenca dixhitale po në të njëjtin vit u vendos taksa e aparatit brenda faturës së energjisë elektrike. Një taksë e papaguar më parë nga shqiptarët por që të ardhurat e saj do të ndihmonin buxhetin e RTSH-së në krijimin e mundësive për blerjen e pajisjeve të reja moderne sipas standardeve të teknologjisë bashkëkohore. Pra, nuk mund të ketë shërbim pa parapagim ose pagesë të vazhdueshme.

Lind pyetja: A është e mundur që të arrihet në më pak se katër muaj realizimi i plotë i një procesi të tillë, i cili nuk u realizua prej kaq vitesh? Nëse do të merrnim parasysh informacione të dhëna për publikun nga specialistet e fushës, një ndër faktorët që mund të çojë në dështimin e procesit të dixhitalizimit është afati i kërkuar nga firma gjermane e cila në kontratën e nënshkruar kërkon një periudhë prej njëzetë e katër muajsh për realizimin e plotë të këtij procesi.

Një tjetër fakt është infrastruktura e nevojshme për vendosjen e impianteve, si dhe sasia e shumës që shteti duhet t'i paguajë kompanisë. Fatura e këtij procesi shkon në rreth 23 milionë euro, dhe për këtë firma gjermane ka vendosur kushtet e saj në kontratë, kushte të cilat nuk janë bërë të ditura për publikun. Firma kërkon që pagesa të bëhet me dy këste, përkatësisht: i pari, rreth 10% e vlerës të paguhet brenda 15 ditëve nga firmosja e kontratës në formën e një paradhënie dhe i dyti në momentin e dorëzimit të transmetuesit në shtetin tonë. Një kusht ky që e vendos në pozitë të vështirë

qeverinë tonë. Kjo pasi qeveria do të duhet të vendosë garanci shtetërore për shumën e kërkuar (sipas kushteve të kontratës), duke garantuar marrjen e një kredie në një nga bankat e njohura europiane për llogari të RTSH-së.

Përveç kushteve të pranuar, me sa duket firmosja e kësaj kontrate u vendos vula dhe të ashtuquajturit tender skandal që bllokoi procedurën për këto dy vite, tender i nisur në kohën e qeverisë së shkuar dhe i menaxhuar tashmë nga Ministria Harito. Proces shumë i përfolur për shkak të akuzave të opozitës së dikurshme sot në pushtet dhe shkaktar i debateve publike e frenimit në gjetjen e zgjidhjeve nga palët parlamentare. Me sa duket, konflikti i vazhdueshëm politik me akuza të ndërsjella për korrupsion ndërmjet dy qeverive, asaj të shkuar dhe kësaj aktuale, përfituese në këtë rast doli kompania në fjalë, e cila fitoi gjyqin mbi këtë tender dhe ka të drejtën të zbatojë punimet sipas kushteve të kontratës së firmosur.

Morali dhe mesazhi në këtë rast është i thjeshtë, sepse nëse kjo klasë politike do të kishte punuar për të arritur në një marrëveshje në funksion të lehtësimit të realizimit të këtij procesi, dhe të gjenin gjuhën e përbashkët pa përdorur tone agresive, do të na e kishin kursyer shumë faturën financiare. Do të na kishin kursyer kohën, dhe do të kishim një përparim gradual drejt realizimit të procesit të dixhitalizimit, duke krijuar infrastrukturën e nevojshme teknike, po ashtu edhe atë ligjore, për ta përballuar me sukses dhe dinjitet këtë sfidë sipas standardeve europiane.

Por me sa duket ne do të vazhdojmë të paguajmë për vendimet e çdo qeverie që vjen e shkon. Kjo sepse referuar të gjitha modeleve që kemi patur prezente, në qeverinë tonë merren vendime, kryhen veprime, firmosen kontrata e marrëveshje dhe propozimi apo vendimi për ndryshim të legjislacioneve përkatëse bëhet pas çdo

vendimi, që të shkojë në funksion të veprimeve. Do të kemi ndryshim dhe në ligjin e RTSH-së.

Përfundimi është po ai, gjendemi me një kontratë në dorë që do ta paguajmë ne të gjithë, për hir të mekanizmit të madh, të quajtur shtet. Dhe për sa i përket deklaratave mbi transmetimin dixhital që do të ofrohet falas, duhet të mos harrojmë rritjen e taksës në të ardhmen, mbi aparatit së bashku me faturën e energjisë elektrike, por të fillojmë të heqim diçka mënjane, sepse kjo taksë i vjen indirekt TVSH-së dhe vjen në rritje në proporcion me rritjen e të ardhurave për frymë të popullsisë. Është taksë e njëjtë si ajo për biznesin, makinën apo shtëpinë, dhe kjo taksë i ofrohet TVSH-së për shërbimin e tij.

Edhe pse dixhitalizimi ofron një mbulim më të madh të popullsisë me shërbimin internet dhe ofron cilësi mediatike më të lartë, çka do të thotë përgjegjësi, apo shkallë informimi më të gjerë, përfundimi mbetet i njëjtë: paguaj që ta kesh. Minimumi, një dekoder do të blihet, (ndërsa ne duhet të bëjmë maksimumin).

MINISTRIA PËR MARRËDHËNIET ME PARLAMENTIN

Jona HOXHAI, BSc

Ministria e Marrëdhënieve me parlamentin (MMP) në mungesë të buxhetit dhe një programi për t'u zbatuar, vazhdoi edhe në muajin mars me takime për të mbajtur në vijë marrëdhëniet e parlamentit me qeverinë.

Marsi filloi me një takim të Ministres Znj. Valikaj (Felaj), e cila është e gatshme për ndryshime dhe reforma në punën e Kuvendit të Shqipërisë me vizionin e arritjes së objektivave në mënyrë më efikase, takim ky i zhvilluar me Z. Marcus Johnson përfaqësues i USAID Albania, Znj. Elina Koci dhe Z. Jay Carver, për të diskutuar për projektin e instalimit të sistemit audio/video në seancat gjyqësore, për ndryshimet që duhet të bëhen në Kodin e Procedurës Penale, për ta sjellë atë në linjë me Kodin e Procedurës Civile. Takim tjetër gjatë muajit mars ishte ai me Ambasadorin e SHBA Z. Donald Lu, për të diskutuar për vështirësitë politike që janë bërë publike në Shqipëri për momentin, duke shprehur të mirëqenë faktin që të dyja palët janë të gatshme për bashkëpunim dhe Shqipëria mirëpret ndihmën miqësore të SHBA-ve për zgjidhjen e pështjellimeve publike.

Një ngjarje e bukur dhe humane u bë publike nga MMP, pikërisht në muajin e festës së gruas. Vendosja e mamografisë së lëvizshme në përdorim të të gjitha grave mbi 50 vjeç, të Kuçovës, Perondisë dhe Kozarës që kishin mundësinë të planifikonin vizita falas gjatë gjithë javës së 8 Marsit. Gjithashtu gjatë Marsit ministrja vizitoi strukturat e Partisë Socialiste në njësinë e re bashkiake në Kuçovë.

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

Flutura GJANA, BSc

1- Strategjia Shqiptare e Taksimit Rrugor

Një ndër temat më të rëndësishme të këtij muaji në fushën e transportit ka qenë "Strategjia Shqiptare e Taksimit Rrugor", e cila u konkretizua më datë 13 mars me nënshkrimin e një kontrate konsulence me kompaninë "Egnatia Odos". Në kuadër të diskutimit të këtij projekti Ministri Edmond Haxhinasto, më 24 mars, mori pjesë në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave për të argumentuar nevojën e miratimit nga Parlamenti të marrëveshjes së "Strategjisë Shqiptare të Taksimit Rrugor". Qëllimi i këtij projekti, që ka një vlerë prej 149. 117 Eurosh është përcaktimi i segmenteve në të cilët do të vendosen tarifa qarkullimi.

Pse shihet e nevojshme të nënshkruhet një marrëveshje konsulence me kompaninë në fjalë, profili i së cilës fokusohet në aktivitete që lidhen me menaxhimin, supervizimin apo kontrollin e karakteristikave teknike të rrugëve? Ndërkohë ky projekt, që duhet të realizohet brenda 8 muajve, duhet të përfshijë një analizë në nivel politikash apo identifikimin e segmenteve rrugore potencialisht të përshtatshme për aplikimin e taksës rrugore. Çfarë lloj konsulence do mund të japë kompania "Egnatia Odos" për ndërtimin e Strategjisë Shqiptare të Taksimit Rrugor?

Vërtetë jemi në situatën që rrjeti rrugor ka nevoja të mëdha për mirëmbajtje dhe qëllimi i këtij taksimi është gjetja e parave për mirëmbajtjen e tij, por pse kjo barrë duhet të bjerë direkt te qytetarët? Pse duhet paguar për rrugë që janë ndërtuar me taksat e qytetarëve? Aktualisht shqiptarët paguajnë taksë regjistrimi vjetore, taksë qarkullimi 27 lekë për çdo litër karburanti (pa përfshirë këtu Tatimin

mbi Vlerën e Shtuar) e tashmë duhet të paguajnë edhe taksë qarkullimi për rrugë pa standarde, ku kalimi në to ndër të tjera mund t'u dëmtojë dhe automjetet. Lind natyrshëm pyetja, a janë kryer kontrollet dhe analizat e duhura teknike për të parë nëse kompanitë që kanë qenë përgjegjëse për ndërtimin e segmenteve të caktuara rrugore kanë arritur të realizojnë punën në cilësinë dhe standardin e duhur? Secili nga ne ka qenë rëndomtë dëshmitar i ndërtimit të një rruge të re dhe daljes së saj jashtë funksioni brenda një periudhe të shkurtër, kjo për shkak të cilësisë së dobët të punimit apo materialeve të përdorura. Nëse do t'i kushtojmë vëmendje kontrollit cilësor të rrugëve në momentin e përfundimit të ndërtimit të tyre, padyshim që dhe kostoja e mirëmbajtjes së tyre do të ishte në shifra shumë herë më të ulëta. Për të mos harruar që jemi në një periudhë kur ekonomia është në rënie dhe varfëria po rritet. A është kryer ndonjë studim për impaktin që do të kenë këto taksime në xhepin e një qytetari shqiptar? Sa do të ulët mirëqenia?

Ndërkohë që duhen 8 muaj për të realizuar këtë projekt, për Rrugën e Kombit aplikohet një politikë tjetër. Segmenti është shpallur në koncesion dhe flitet që tarifa për mjetet e vogla nuk do të jetë më e vogël se 5 Euro. Përveç kësaj, ministri i Financave ka filluar fushatën për rrugën e Arbrit, pasi edhe ajo do të jepet me koncesion. Ky diferencim sipas ministrit Edmond Haxhinasto ndodh pasi këto segmente kanë nevojë për investime të mëdha kapitale. Rrugët të cilat priten që të bëhen me pagesë do të jenë Rruga e Kombit, rruga Tiranë-Elbasan, për të cilin projekti ka parashikuar edhe toll station (stacion pagese), rruga e Arbrit, bypass-i i Vlorës dhe ai i Fierit. Pra akoma pa filluar mirë ky projekt, kemi të përcaktuar pesë segmente rrugore ku do të aplikohet taksimi. Për çfarë analizash do të shpenzohen 149 117 Euro, kur tashmë janë përcaktuar pesë segmente ku do të

aplikohet taksimi? Moria e këtyre pyetjeve përballet me përgjigjen e vetme se nuk po tregohet një qasje e mirë drejt kësaj çështjeje, ku shtimi i barrës për qytetarët shihet si zgjidhja e vetme, në një kohë kur nuk janë konsumuar të gjitha alternativat.

2- Rrugët e vdekjes

Çdo vit përballemi me një numër në rritje të aksidenteve rrugore. Sipas INSTAT-it që nga viti 1995 deri në 2013-ën kanë humbur jetën në aksidentet automobilistike 5769 persona. Një numër që çdo vit po vjen në rritje. Padyshim që nëse i referohemi raporteve të policisë, thuhet që shkaku kryesor ka qenë shpejtësia tej normave të lejuara apo shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e drejtuesve të mjeteve. Por shkaqe të tjera shumë të rëndësishme që ndikojnë në këtë numër të lartë aksidentesh janë niveli i sigurisë që ofrojnë rrugët tona, cilësia dhe mungesa e sinjalistikës.

Legjislacioni dhe Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë përcakton mjaft mirë kategoritë e rrugëve, standardet dhe parametrat përkatëse që duhet të kenë apo mënyrën sesi duhen menaxhuar. Por për arsye sociale apo zgjidhje të momentit në terren, konstatohen projekte në zbatim që lihen përgjysmë dhe shfrytëzimi i rrugëve fillon pa përfunduar ndërtimi i tyre.

Vetëm në muajin mars kanë ndodhur 11 aksidente rrugore, ku 5 prej tyre kanë ndodhur në akse rrugore që konsiderohen pika të zeza (sipas një studimi të vitit 2011 ku janë përcaktuar pikat e rrezikut në rrugët e Shqipërisë, harta e pikave të rrezikut dhe lista e këtyre pikave). Ndërkohë që numri aksidenteve dhe viktimave rritet, Ministria nuk ka politika për ndërtimin e planeve apo projekteve për rehabilitimin e zonave që konsiderohen me rrezikshmëri më të lartë, çështje e cila duhet të ishte prioritet për këtë Ministri.

Edukimi i qarkullimit sidomos në sezonet turistike mbetet një mision i pamundur.

Referimie

<http://www.egnatia.eu/page/default.asp?la=2&id=2240> 2 Treguesit e varfërisë sipas rajoneve–

<http://www.instat.gov.al/al/themes/niveli-i-jetes%C3%ABs.aspx>

<http://acp.al/news/760/Pas-Durres-Kukes,-ja-rruget-e-tjera-qe-do-behen-me-pa-ge-e/>

<http://www.instat.gov.al/al/themes/transporti.aspx?tab=tabs-5>

Ligjin nr.8378,dt.22.7.1998

<http://top-channel.tv/artikuj.php?c=12>

http://www.transporti.gov.al/files/userfiles/Qarkullimi_dhe_siguria_rrugore/Harta_e_Pikave_te_Zeza_2011.pdf

http://www.transporti.gov.al/files/userfiles/Qarkullimi_dhe_siguria_rrugore/Lista_e_Pikave_te_Zeza.pdf

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES.

Sokol KONDI, MSc

1- Situata ekonomiko-tregtare; një realitet, dy qëndrime

Ministria ka qenë jashtëzakonisht aktive gjatë këtij muaji. Mund të thuhet pa frikë se mund të jetë një ndër ministritë më aktive për sa i takon takimeve. Në fakt ministri Ahmetaj ka zhvilluar mbi pesë vizita zyrtare, në të cilat është takuar me homologë apo përfaqësues të lartë të BE-së dhe jo vetëm, me të cilët ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi apo ka ndarë pikëpamje mbi ecurinë e reformave në Shqipëri, ndër të cilat mund të përmenden marrëveshja për nxitjen e tregtisë me Kosovën, e nënshkruar në Tiranë më 23 mars, si dhe ajo me Bullgarinë, me të njëjtin qëllim, e nënshkruar po në kryeqytetin tonë, më 20 mars. Më 11 mars, në një dalje publike, ministri njoftonte se do të faleshin në masën 80% gjrobat për mos-pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të bizneseve, për ata që i bëjnë këto pagime brenda një afati të caktuar, duke e paraqitur një nismë të tillë si një formalizim të tregut. Më 3 mars, ministri Ahmetaj nënshkroi me BE-në marrëveshjen COSME, për mbështetjen financiare të SME-ve, për konkurrueshmërinë dhe inovacionin e sipërmarrjeve, që ka të bëjë me një fond prej 2,3 mld eurosh, që vë në dispozicion BE-ja për vendet e ndryshme, dhe nga i cili pritet të përfitojnë edhe sipërmarrjet shqiptare. Në 17 mars ministri Ahmetaj do ta vlerësonte me këto fjalë punën e ministrisë së tij: *"Rritja ekonomike në 2014 u arrit falë reformave të ndërmarra nga qeveria në sektorët kyçe. Së bashku me FMN jemi të bindur se duke ruajtur tempin e duhur të reformave strukturore, do të bëjmë të mundur që rritja ekonomike*

në 2015 të arrijë nivelin e 3%". Nga e gjithë kjo tablo duket sikur zhvillimi ekonomik, gjendja e bizneseve dhe tregtia në vend po lulëzojnë.

Por një peizazh krejt të ndryshëm paraqesin shifrat nga institucionet zyrtare të statistikave. Për shembull, për sa i takon tregtisë, rezulton se në muajin Janar 2015 eksportet e mallrave arritën vlerën 18 mld lekë, duke u ulur me 0,6 % në krahasim me Janar 2014 dhe 8,0 % në krahasim me Dhjetor 2014. Rënie ka patur edhe në importet e mallrave, ku rezulton së në muajin Janar 2015 ato arritën vlerën 35 mld lekë, duke u ulur me 0,2 % në krahasim me Janar 2014 dhe 35,6 % në krahasim me Dhjetor 2014. Rënia e importeve mund të ketë të bëjë në mënyrë direkte me rënien e fuqisë blerëse. Kështu që rritja e sivjetme ekonomike për të cilën flet ministri, jo domosdoshmërisht mund të ketë ndikuar në fuqinë blerëse të shtresës së mesme dhe të asaj të varfër, apo edhe të vetë shumicës së bizneseve. Defiçiti tregtar i janarit (merret ky muaj si pasojë e studimeve tremestrale), pra diferencave mes eksporteve dhe importeve në vendin tonë, ka qenë 17 mld lekë në favor të importeve, duke u rritur me 0,3 % në krahasim me janarin 2014.

Ndërkohë është vënë re edhe se indeksi i çmimeve vjetore për muajin shkurt, por edhe atë mars ka prekur një rritje përkatësisht prej 2,3 dhe 2,2%. Rritja vjetore e indeksit të çmimeve që varfëron xhepat e taksapaguesve, për sa i takon muajit shkurt 2015 është ndikuar kryesisht nga grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" me +1,88 pikë përqindje. Çmimet e grupit "Pije alkoolike dhe duhan" kanë kontribuar vetëm me +0,23 pikë përqindje. Çmimet e grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" kanë kontribuar me +0,12 pikë përqindje.

Po te kemi parasysh, programin e Rilindjes, një ndër "kuajt e betejës elektorale" ka qenë ulja drastike e TVSH-së për ushqimet

dhe ilaçet bazë, gjë e cila ka mbetur në kalendrat greke, sepse jo vetëm që nuk ka ndodhur, por sikurse cituam më lart, ka qenë pikërisht ky grup që ka ndikuar më tepër në rritjen e çmimeve dhe që sigurisht ka prekur më tepër ekonominë e brishtë të konsumatorëve të varfër në vendin tonë, që nuk janë të pakët.

2- Turizmi, shumë panairë për asgjë

Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT) vetëm duke nisur që nga fillimi i këtij viti, e ka përfaqësuar turizmin shqiptar në të paktën 5 panairë ndërkombëtare, sikurse kanë qenë ato të datave 19-22 shkurt në Pragë, 12-14 shkurt në Milano, 28 janar-1 shkurt në Madrid, 15 janar në Vienë, dhe 4-8 mars në Berlin. Pa harruar panairët e shumtë të vitit 2014, mes të cilëve më i rëndësishmi është ai i Londrës, ku turizmi shqiptar përfaqësohet çdo vit dhe që kap një shifër rreth 100 mijë eurosh për marrjen e hapësirës me qera, arredimin, akomodimin dhe shpenzimet e tjera administrative. Mund të thuhet pa frikë se me këtë ritëm AKT merr pjesë në të paktën 10 panairë ndërkombëtare në vit, me vlera që pas asnjë dyshim mund t'i kalojnë 200 mijë eurot, kur vetëm pjesëmarrja në njërin prej këtyre panairëve kushton rreth 100 mijë euro. Pra nga buxheti vjetor prej rreth 700 milionë lekësh të vjetra që qeveria miratoi sivjet për AKT, duke i shtuar 100 milionë lekë buxhetit të vjetshëm, thajse gjysmën kjo agjenci e shpenzon për pjesëmarrje në panairë ndërkombëtare turizmi. Në rast se ky do të ishte një investim që do të përkthehej në rritjen e numrit të turistëve që vijnë në Shqipëri, kjo do të ishte fantastike. Por duke qenë se të dhënat e tre-mujorit të tretë të 2014, që janë të dhënat e fundit zyrtare lidhur me ardhjet e turistëve në Shqipëri, flasin për një situatë që zor se e kalon atë të vitit 2012, që ka qenë viti më i mirë turistik në periudhën e qeverisë së kaluar, nuk është e qartë se cila është strategjia dhe vizioni i

pjesëmarrjes në të gjitha këto panairë dhe cili është ndikimi i tyre direkt në shtimin e turistëve të huaj në vendin tonë.

Me shifra në dorë, po të krahasohet tremujori i parë i vitit 2013, me atë të 2014-s, pra gjashtë muaj pasi qeveria e re e kishte marrë detyrën, Shqipërinë e kanë vizituar rreth 27,300 turistë perëndimorë më shumë. Po të kihet parasysh se viti 2013 pati rreth 9% rënie të numrit të turistëve në krahasim me vitin pararendës, kjo rritje për 2014-n është me të vërtetë minimale. Duke qenë se turistët afatgjatë në vendin tonë, pra turistët që qëndrojnë më shumë se një javë përbëhen në masën mbi 80% nga turizmi patriotik, pra nga shqiptarët e Kosovës dhe të Maqedonisë, turistët e tjerë janë kryesisht ditorë dhe sikur të gjithë turistët perëndimorë extra të 2014-s në rastin më ekstrem të kishin shpenzuar shifrën marramëndëse prej 1 mijë eurosh në ditë në vendin tonë në qëndrimin e tyre ditor, nuk do t'i justifikonin dot kurrsesi shpenzimet e ethshme dhe kuturu për panairë ndërkombëtare të AKT-së. Agjencia, që ka një buxhet prej 700 milionë lekësh për 2015-n, bën mirë që këto para t'i përdorë në radhë të parë për të promovuar turizmin shqiptar te vetë shqiptarët, pasi shpenzimet e këtyre të fundit për pushime turistike nëpër destinacione të huaja luksi, është përllogaritur se mund të shkonin sa e gjithë shuma e turizmit patriotik e marrë së bashku. Me një vizion promovimi turistik vetëm me fletushka dhe panairë, apo argëtim operatorësh turistikë të huaj në vendin tonë, është e drejtë të shtrohet pyetja: turizmi shqiptar "*quo vadis*"?

Referime

Instat.gov.al

Albania.al

Ekonomia.gov.al

MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

Rezarta CAUSHAJ, BA

1-Rilindja apo arnimi qyteteve ?!

Zv. Ministri i Ministrisë së Zhvillimit Urban, Z. Alfred Dalipi, ka prezantuar në datën 23 Mars i ftuar në studion e TV Vizion + projektin “Rilindja e qyteteve” ku sipas tij pritet që të rehabilitohen një sërë qendrash qytetesh. Fatkeqësisht, prezantimi nuk ofroi ndonjë referencë kohore mbi projektin e mësipërm, sa qytete dhe cilat kanë prioritet në këtë projekt, gjithashtu ai nuk ofroi detaje përtej faktit se pritet që të shtrohen trotuare në pjesë të caktuara të qyteteve, të vendosen drita, sinjalistika dhe një “mobilim” i përgjithshëm siç e përshkroi Zv. Ministri. Nëse nuk e interpretojmë gabim gjithë tonin e bisedës, ideja është që të bëhet një investim rrufe, me fonde minimale për të arnuar gjendjen e disa qyteteve duke e shitur atë për investim real apo ky është një plan i mirëmenduar, i cili përveçse do të rregulloj pjesën estetike të tyre, përfshin edhe një rivitalizim të këtyre qendrave urbane?

Është e pamundur të kuptohet një fakt i tillë, jo vetëm nga prezantimi i mësipërm, por sidomos sepse Ministria e Zhvillimit Urban nuk ka publikuar një projekt të tillë në letër, nga i cili të mund të nxirren detajet dhe pse jo të ketë edhe një debat publik. A është ky plan në harmoni me planin për lirim e hapësirave urbane? Çfarë nënkuptohet me rivitalizim: thjeshtë një sistemim i qendrave të qyteteve apo një rimodelim i tyre? Dallimi midis dy koncepteve do të ishte rrënjësor sepse në rastin se plani është një sistemim i thjeshtë kjo do të thotë se Ministria po bën shumë bujë për asgjë dhe pas “suvatimit” të radhës qytetet do të vazhdojnë të kenë të njëjtën fytyrë. Ndërkohë që rimodelimi i qyteteve s’mund të jetë veçse një projekt

afatgjatë, që kombinon jo vetëm zbrazjen e hapësirave publike, por edhe se si do të shfrytëzohen këto hapësira të rifituara.

Ministri foli për rëndësinë që ka zgjerimi i hapësirave të këmbësorëve në projektet për secilin qytet, por pyesim se çfarë përfshin ky plan për automjetet dhe trafikun e renduar? A ka një plan bashkërendimi me Ministrinë e Transporteve në këtë aspekt? Natyrisht këmbësorët duhen favorizuar, por edhe drejtuesit e automjeteve janë qytetar.

Dhe si për të fshehur mangësitë, Zv. Ministri u nxitua të zbuloj se Ministria është duke shqyrtuar projekte të arkitektëve amator, jo vetëm të studiove, dhe ka shumë prej tyre që janë interesante, por nuk ka zbuluar a ka ndonjë projekt konkret të miratuar prej “konkursit”? Apo mos vallë i referohet konkursit “Arkitektët e rinj për Zhvillim Urban”, ku Znj. Gjermani, titullare e Ministrisë së Zhvillimit Urban, shpalli se 3 fituesve do t’i ofrohej mundësia e ekspozimit për dy javë të punës së tyre dhe se Ministria do punonte me donatorët me shpresën që ato të mund të realizoheshin? Pra, ndryshe nga sa pretendohet konkursi nuk është mbi projekte arkitekturore urbane, por një konkurs akademik ku pjesëmarrësi paraqesin punët e tyre dhe pastaj projektet i fitojnë studiot.

Në të njëjtën mënyrë evazive, është trajtuar edhe çështja e investimeve në qytetin e Tiranës, ku Bashkia ankohet për mungesë fondesh, ndërkohë që Ministria e Zhvillimit Urban e akuzon për mungesë projektesh (ose paaftësi më saktë). Në fakt Bashkia e Bulqizës duket se paska një grup shumë të aftë brainstorming-u sepse sipas Zv. Ministrit ajo ka paraqitur plotë 30 projekte dhe janë investuar plotë prej tyre. Fakti që Bashkia e Bulqizës drejtohet nga një Kryebashkiak socialist është vetëm një detaje “pa rëndësi” në diskursin e mësipërm.

2- Emission sipas kërkesave të dëgjuesve?!

Meqë jemi në kuadër të projekteve, Ministria e Zhvillimit Urban paska edhe një projekt "Ndërgjegjësimi dhe integrimi social nëpërmjet procesit të legalizimit dhe urbanizimit të objekteve/zonave informale, të komunitetit rom të zonave informale", projekt me një titull bombastik, i cili ka si synim ndërgjegjësimin e komunitetit për urbanizimin e zonës dhe për njohjen me nevojat e saj për shërbime sociale ekonomike dhe mjedisore. Në radhë të parë nuk shpjegohet cilat janë këto plane urbane të cilat do të prekin komunitetin rom, që nëse ekzistojnë, na bëjnë shumë entuziast duke qenë se janë një nga komunitetet më të marginalizuara në Shqipëri (sidomos dhe për faktin se politika nuk i sheh si burim votash). A është ky një projekt i ideuar nga Ministria e Zhvillimit Urban apo është një projekt në thelb social në të cilin kjo Ministri është përfshirë? Nga pjesa e publikuar nuk arrihet të kuptohet nëse qëllimi i projektit është që të ndërgjegjësoj komunitetin (dhe në këtë rast për çfarë) apo të dëgjoj problemet e tyre e t'i përfshij ato në Planin e Përgjithshëm Vendor? Do të ishte shokuese që Ministria e Zhvillimit Urban, që në kuadër të të zhurmshmes Reformë Territoriale ka nxjerr lagje të tëra në rruge, tashmë të filloj të marr parasysh kërkesat dhe problematikat e qytetarëve të zonave informale. Akoma më shumë vështirësi kemi të kuptojmë fjalinë "Përveç njohjes me problematikat e qendrave të tyre të banimit, përfshirja e tyre (komunitetit) shkurton procedurat e planifikim-urbanizimit dhe kostot e tij financiare", ndërkohë që nuk shpjegohet se si do të përfshihet në terma konkret komuniteti rom. Apo përse nuk përmendet gjatë komuniteti rom dhe se çfarë nevojë e ka prodhuar një projekt të tillë, që më shumë duket se i shkon përshtat organizatave të Shoqërisë Civile se një Ministrie.

3- Inspektimi apo (ri)promovimi i projekteve?

Si për koincidence në të njëjtën ditë, në kuadër të të njëjtit projekt në fakt Kryeministri i Shqipërisë, Z. Rama ka vizituar Qeparonë⁶ e Gjirokastrën për të inspektuar punimet që po bëhen aty. Ndër punimet e kryera tashmë në Qeparo, në faqen e Ministrisë shkruhet: "Është rikonstruktuar shëtitortja buzë detit, janë sistemuar rrugicat dhe sheshi i parkimit të mjeteve. Janë trajtuar fasadat dhe është bërë gjelbërimi dhe ndriçimi i hapësirës përreth. Sheshi i ri po kthehet në gjendje funksionale dhe tërheqës për turistët."

Punimet e mësipërme janë një lajm shumë i mirë dhe shumë i mirëpritur, por ajo që të bën të dyshosh midis asaj që ndoshta pretendohet të bëhet dhe asaj që tashmë është bërë është fakti që nga pamjet e publikuara tregojnë punime të sapofilluara dhe përveç gurëve dhe dheut, askund nuk u pa gjelbërim. E njëjta deklaratë është bërë edhe për inspektimin e punimeve në qytetin e Gjirokastrës, ku pretendohet po investohet më tepër se 20 Vitet e fundit të marra bashkë.

Përtej pretendimeve të investimeve, ajo që duam të ndalemi është se Z. Kryeministër së bashku me një shpurë deputetësh të zonës zhvillon një vizitë me idenë për të "inspektuar" punimet që janë kryer. Nuk dihet nëse kjo është një nismë e bashkërenduar me Ministrinë e Zhvillimit Urban për të kontrolluar fillimin apo cilësinë e punimeve apo se mbi ç' bazë institucionale bëhet një gjë e tillë? A është kryeministri i shoqëruar nga një grup ekspertësh të cilët mund të vlerësojnë ecurinë e projekteve?

A është kjo një strategji për të parë a po zhvillohet puna sipas planit në kantier duke bërë vizita rrufe, si kanë bërë disa krerë të tjerë të qeverisë⁷? Rasti i parë është mjaftë I zakonshëm dhe i shikon titullarët

e ministrive duke promovuar të njëjtin projekt një herë kur ideohet, pastaj kur fillon, pastaj gjatë ndonjë fushate të radhës dhe kur përfundojnë.

Ndërsa vizitat e papritura si mënyrë për të kontrolluar zbatimin e planeve, janë tregues i mungesës së kapaciteteve institucionale për të kontrolluar rregullsinë, vijueshmërinë dhe zbatueshmërinë e projekteve. Gjithashtu janë tregues i mungesës së besimit ndaj personave me pushtetin e ngarkuar institucionale për të bërë këto detyra dhe është një politikë që nuk duhet kurrsesi të inkurajohet, sidomos kur këmbëngulet që këta të fundit vendosen në poste në bazë të meritës. Prandaj, kryeministri duhet t'ia lë detyrën e inspeksionit Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe drejtorive që kanë kompetencat përkatëse si e vetmja mënyrë që të krijohet një disiplinë institucionale.

Referime

<https://www.youtube.com/watch?v=i42PqvjKcLg>

<http://www.zhvillimiurban.gov.al/al/newsroom/fjalime/fjala-e-ministres-gjermani-ne-eventin-e-ndarjes-se-cmimeve-fituese-per-konkursin-arkitektet-e-rinj-per-zhvillim-urban1426607546&page=1>

<http://www.zhvillimiurban.gov.al/al/newsroom/lajme/integrimi-dhe-ndergjegjesimi-permes-legalizimit-dhe-urbanizimit-zhvillohen-degjesa-publike-me-komunitetin-ne-saver-dhe-otllak&page=2>

<http://www.zhvillimiurban.gov.al/al/newsroom/lajme/kantieret-e-rilindjes-ne-qeparo&page=1>

<http://www.zhvillimiurban.gov.al/al/newsroom/lajme/gjirokaster-me-shume-investime-sesa-ne-20-vite-bashke&page=1>